 Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	Faqe 1 nga 52
----------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------	--------------------------------------	------------------

Vlerësim i Ndikimit Mjedisor dhe Social për Vrojtim gjeofizik 2D - Blloku Dumre – në tokë, Shqipëri

-

PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE

Rish.	Data	Përgatitur nga	Rishikuar nga	Aprovuar nga
Rish. 0	16 Gusht 2021	 	 Eni HSEQ-NR AMTE/STAM	 Eni Albania



 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 2 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	--------------------------

TABELA E PËRMBAJTJES

1	HYRJE	3
1.2	QËLLIMI I PËRMBLEDHJES JO TEKNIKE	5
1.3	PROCESI I VNMS-SË.....	5
2	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	6
3	ANALIZA E ALTERNATIVAVE.....	11
4	KUSHTET BAZË TË MJEDISIT	11
4.1	KUSHTET BAZË TË MJEDISIT FIZIK	14
4.2	KUSHTET BAZË TË MJEDISIT BIOLOGJIK.....	16
4.3	KUSHTET BAZË TË MJEDISIT SOCIAL	17
5	METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT.....	19
6	VLERËSIMI I NDIKIMIT MJEDISOR	21
7	VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK.....	40
8	NDIKIMET E MUNDSHME NDËRKUFITARE	51
9	PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT	51

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>3 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	-----------------------------

1 HYRJE

Eni është një kompani energjitike e integruar shumëkombëshe me qendër në Itali, që zhvillon operacione në 73 vende të globit. Në Dhjetor 2019, Eni Albania B.V. (këtu e më poshtë "Eni") nënshkroi një Kontratë me Ndarje Prodhimi me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Shqipërisë për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Bllokun Dumre në rajonin qendror të vendit, aprovuar me VKM nr.187 datë 26/02/20. Eni po planifikon të kryejë vrojtimin gjeofizik të premtuar në Bllokun Dumre në vitin 2022.

Vrojtimet gjeofizike përdoren gjerësisht në të gjithë botën për të përfutur një pamje të detajuar të ndërtimit gjeologjik në sipërfaqen e tokës. Qëllimi i vrojtimet gjeofizik të propozuar do të shfrytëzohet nga Propozuesi i projektit për të vlerësuar potencialin të hidrokarbureve në zonën e vrotuar dhe informuar mbi vendndodhjet e mundshme të vrojtimet për aktivitete të shpimit kërkimor. Megjithatë, mund të duhen disa vite përpara se Eni të kuptojë plotësisht praninë e mundshme të hidrokarbureve në këtë pjesë të Shqipërisë dhe për të vendosur nëse mund të prodhohen hidrokarbure.

Të dhënat gjeofizike do të përftohen përgjatë afërsisht 200 km linja burimesh (LB) dhe 311 km linja marrësish (LM), të ndara në shtatë trase kryesore. Vrojtimi do të zhvillohet në përputhje me rregulloret kombëtare, standartet e korporatës Eni dhe praktikat e mira industriale ndërkombëtare. Operacionet e planifikuara të fillojnë në Janar të 2022, pasi të jenë marrë të gjitha aprovimet e nevojshme, do të zgjasin deri në mes të Dhjetor 2022.

Shqipëria ka një legjislacion të veçantë i cili kërkon vlerësimin e ndikimit në mjedis. Të gjitha projektet me ndikime të mundshme në mjedis duhet të kryejnë Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis përpara fillimit të zbatimit të projektit. Ligji i vitit 2011 "Për mbrotjen e mjedisit" përcakton rregullat për mbrotjen e mjedisit, përfshirë kërkesën për kryerjen e një Vlerësimi të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe marrjen e një Deklarate Mjedisore përpara fillimit të projektit.

VNMS-ja përdoret për të mbledhur informacion në lidhje me mjedisin dhe komunitetet lokale, për të identifikuar ndikimet e mundshme të projektit dhe për të përcaktuar se çfarë është bërë për të zbutur në mënyrë efektive ato ndikime. Ky proces siguron që vrojtimi është planifikuar dhe kryer në një mënyrë që shmang ose minimizon në një nivel të pranueshëm çdo ndikim të mundshëm negativ social dhe mjedisor. Raporti përfundimtar i VNMS-së merr parasysh reagimet e marra gjatë përfshirjes së palëve të interesit dhe takimeve të dëgjësive publike.

VNMS-ja udhëhiqet nga Golder Associate (Golder), një kompani globale konsulentesh inxhinierike dhe mjedisore, e cila operon në të gjitha industritë dhe ofron shërbime konsulence, projektimi dhe ndërtimi përgjatë ciklit të jetës së një projekti, mbështetur nga EMA Consulting krijuar dhe me qendër në Shqipëri. EMA ka një eksperiencë të gjerë në kryerjen e VNM-ve kombëtare dhe procesin e përfshirjes së palëve të interesit për degë të ndryshme të industrisë, përfshirë sektorin e naftës dhe gazit.

Zona e projektit ndodhet në rajonin e Dumresë, në tokë, në Shqipërinë qendore, rreth 40 km në jug të kryeqytetit Tiranë, në një zonë hidrokarbure të eksploruar dhe "provuar" më parë. Blloku Dumre zë një sipërfaqe prej 587 km² (Figura 1). Vendndodhjet e linjave gjeofizike dhe korridoreve respektivë janë përcaktuar bazuar në njohuritë aktuale të Eni-t për zonën, pas një studimi të literaturës dhe një vrojtimi rikonjicioni të kryer nga kompania në Mars 2021 dhe një radhe takimesh të mbajtur me palët e interesit ndërmjet Mars dhe Korrik 2021. Përcaktimi i këtyre koordinatave synon optimizimin e vetë cilësisë së vrojtimet duke reduktuar ndikimet mjedisore dhe sociale si dhe rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë.

Metoda gjeofizike 2D përdoret zakonisht për kërkimin rajonal të hidrokarbureve. Për shkak të përdorimit të gjerë të kësaj metode në mbarë botën, rreziqet e mundshme mjedisore dhe sociale janë të njohura mirë dhe mund të menaxhohen lehtë përmes planifikimit dhe ekzekutimit të kujdesshëm të aktiviteteve.





Figura 1. Vendndodhja e zonës së projektit

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>5 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	-----------------------------

1.2 Qëllimi i Përmbledhjes Jo Teknike

Një Përmbledhje Jo Teknike (PJT) është një dokument i përmbledhur i cili siguron një përshkrim të projektit, procesit të VNMS-së dhe gjetjeve të tij në një mënyrë që është tërheqëse për t'u lexuar dhe kuptuar lehtësisht nga publiku i gjerë.

Ky dokument përfaqëson një Përmbledhje Jo Teknike (PJT) të Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS) për projektin e e propozuar të Vrojtimit gjeofizik 2D në Bllokun Dumre – në tokë, Shqipëri. Ai është pjesë e dosjes së zbulimit të informacionit të projektit dhe paraqet projektin, një përshkrim të gjendjes aktuale të mjedisit fizik, biologjik dhe social në zonën e projektit, ndikimet kryesore në mjedis dhe ato sociale dhe detajon masat e planifikuara për të parandaluar, minimizuar, zbutur dhe shmangur këto ndikime. PJT ndjek të njëjtën strukturë si dhe raporti i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social.

VNMS-ja është kryer në përputhje me kërkesat rregullatore kombëtare për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis dhe standartet e zbatueshme në Shqipëri si dhe bazuar në standartet e Eni-t dhe praktikatat e mira ndërkombëtare të njohura.

1.3 Procesi i VNMS-së

Procesi i VNMS-së është një qasje sistematike për të parashikuar dhe vlerësuar ndikimet e mundshme mjedisore dhe sociale të një projekti të propozuar, duke vlerësuar alternativat dhe hartuar masat e nevojshme zbutëse, menaxhuese dhe monitoruese.

Qëllimi i VNMS-së është të informojë zhvilluesin e projektit në lidhje me çështjet e ndjeshme, problemet dhe ndikimet e mundshme në mënyrë që të hartojë masat e duhura zbutëse (përfshirë ndryshimet në projekt) si dhe të informojë vendimmarrësit dhe publikun për ndikimet në mjedis të lidhura me projektin.


Objektivat kryesore të procesit të VNMS-së janë:

- të identifikojë dhe vlerësojë ndikimet e rëndësishme mjedisore dhe sociale që lidhen me vrojtimitin gjeofizik;
- të identifikojë dhe hartëzojë palët e interesit;
- të vlerësojë alternativat e aktiviteteve të projektit (përfshirë vendndodhjen gjeografike dhe variantet teknike);
- të përcaktojë një nivel (bazë të kushteve mjedisore) përkundrejt të cilit do të monitorohen ndryshimet e shkaktuara nga aktivitetet kërkimore;
- të hartojë masa zbutëse dhe monitoruese për ndikimet e mundshme të identifikuara që të garantojë mbrojtjen e mjedisit natyror dhe human;
- të rrisë ndikimet pozitive të aktiviteteve të projektit.

Procesi i VNMS-së është kryer në përputhje me kërkesat rregullatore kombëtare, politikatat dhe procedurat e Eni-t si dhe bazuar në praktikatat e mira ndërkombëtare për industrinë që përcaktohen në Udhëzimet e Korporatës Financiare Ndërkombëtare (KFN) për Mjedisin, Shëndetin dhe Sigurinë (MSHS) gjatë operacioneve zhvillimore në tokë për naftë dhe gaz.

Procesi i VNMS-së filloi me detyrën e përcaktimit të çështjeve të raportit përkatës, në të cilën u analizuan ndërveprimet e parashikuara të aktiviteteve (aspekteve) të projektit me receptorët bio-fizikë dhe socio-ekonomikë me qëllim identifikimin e rëndësisë së mundshme të tyre dhe nevojën për vlerësim të mëtejshëm.

Raporti i përcaktimit të çështjeve u dorëzua tek autoritetet rregullatore (më 27 Prill 2021) me qëllim konsultimin e hershëm dhe marrjen e mendimeve paraprake dhe udhëzimeve të autoriteteve rregullatore për fazat e tjera të procesit të VNMS-së. Vendimi i AKM-së për Raportin e përcaktimit të çështjeve u dha me datë 20 Maj 2021. Komentet e theksuara në Vendimin e AKM-së janë konsideruar gjatë përgatitjes së kësaj VNMS-je.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>6 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	-----------------------------

Me qëllim që të përgatitet një raport VNMS cilësor, marrja e të dhënave të sakta dhe të besueshme për gjendjen e mjedisit në zonën e studimit përfaqëson një komponent thelbësor, i cili synon të sigurojë një pikë referimi për vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve të mundshme. Mbledhja e informacionit dhe të dhënave për këtë VNMS u bazua në burime dhe metoda të ndryshme. Detajet e informacionit të kërkuar u përcaktuan nga natyra e projektit dhe prandaj ndryshojnë për përbërës të ndryshëm mjedisorë. Gjatë procesit ekspertët mblodhën informacionin ekzistues, vlerësuan përshtatshmërinë e tij në lidhje me qëllimin e VNMS-së dhe zhvilluan qasjet dhe metodat për plotësimin e mangësive të identifikuara të të dhënave. Sezonaliteti është marrë në konsideratë gjatë planifikimit të vrojttimeve për të kryer vizitat në terren në kohën e duhur.

Informacioni mbi karakteristikat e aktivitetit të vrojtimit gjeofizik 2D dhe përshkrimi i kushteve bazë të mjedisit përdoren për të identifikuar dhe vlerësuar rëndësinë e ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative të krijuara nga aktiviteti i sondazhit gjeofizik 2D në kontekstin mjedisor, socio-ekonomik, kulturor dhe shëndetësor.

Procesi i vlerësimit të ndikimit përshkruhet sipas metodologjisë së Eni, e cila është në përputhje me rregulloren shqiptare për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në seksionin **Error! Reference source not found.**

2 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i fushatës së vrojtimit gjeofizik në Bllokun Dumre, planifikuar të zhvillohet në vitin 2022, është përvetësimi i të dhënave gjeofizike 2D të cilat mund të përdoren për të krijuar një pamje të gjeologjisë dhe strukturës në thellësi të nëntokës brenda Bllokut Dumre.

Metoda përdoret gjerësisht sepse siguron të dhëna rajonale që lejojnë krijimin e një imazhi 2D të nëntokës përgjatë linjave gjeofizike dhe kërkon aktivitete më pak të gjera dhe komplekse në terren sesa llojet e tjera të kërkimit.

Të dhënat gjeofizike janë burimi i parë që përdor industria e naftës dhe gazit për prodhimin e hartave dhe imazheve të shtresave shkëmbore. Imazhet gjeofizike janë përdorur për identifikimin e grumbullimeve të mundshme të hidrokarbureve dhe njëkohësisht rreziqet e mundshme për operacionet e shpimit.

Në përgjithësi vrojtimit gjeofizike nuk kërkojnë ndërtimin e objekteve ose infrastrukturave sepse ato përdorin kryesisht pajisje të lëvizshme. Një burim energjie krijon një valë zanore që reflektohet nga formacionet shkëmbore dhe kapet në sipërfaqe nga sensorët rregjistruar (gjeofonët). Sensorët lidhen me një makinë qendrore rregjistrimi nëpërmjet teknologjisë pa kablo.


Vrojtimi gjeofizik do të përfshijë si Linjat e Burimeve (LB) ashtu edhe Linjat e marrësve (LM). Linjat e burimeve (LB) janë linja teorike në të cilat do të aplikohen burimet e energjisë. Linjat e marrësve (LM) janë linja teorike ku do të zhvillohet rregjistrimi i valëve gjeofizike të kthyera.

Sa lidhet me metodat e burimit të energjisë, zakonisht përdoren dy lloje teknikash, në varësi të thellësisë target të hulumtimit dhe natyrës së sipërfaqes së zonës operacionale:

- Teknika me vibrime (dridhje) (Figura 2), dhe
- Teknika me ngarkesë lëndësh plasëse (Figura 3).

Zgjedhja e burimit të energjisë varet nga topografia, kushtet e terrenit dhe cilësia e të dhënave gjeofizike që mund të përftohen nga gjeologjia e njohur e nëntokës.

Në projektin aktual, si kamionët vibrues edhe pusët e plasjeve planifikohet të përdoren. Vrojtimi do të përdorë një kombinim të sondave portative me ato konvencionale, për shpimin e puseve të cekët ku do të vendoset lënda plasëse (pentolit) në sasi të vogël. Vibruerit do të jenë burimi i preferuar në zonat fushore, ndërsa pusët plasës do të përdoren më së shumti në zonat malore.

	Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 7 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------	--------------------------------------	------------------

Si LM ashtu edhe LB aktualisht janë paraqitur si gjurmë të drejta (Figura 1). Megjithatë, në praktikë ato nuk do të jenë patjetër të drejta dhe do të përshtaten lokalisht sa herë nevojitet dhe është e mundur për të shmangur receptorë të ndjeshëm mjedisorë (ndërmjet të tjerash ndërtesa ose shtëpi, puse uji, linja transmetimi, vende ose objekte arkeologjike, trupa ujorë etj.) dhe reduktuar rreziqet ndaj shëndetit dhe sigurisë (p.sh. duke shmangur shpatet e pjerrët ose aty ku rreziku i rrëshqitjeve të tokës është i lartë). Shmangia maksimale anësore prej 450 m në të dy anët e LM (ose e mesmja e LM në rastin e linjës së gjerë), do të thotë që korridori gjeofizik ku do të vendosen të gjitha pikat e plasjes dhe gjeofonët është planifikuar të jetë 900 m i gjerë. Gjurmët finale do të argumentohen në mënyrën e duhur dhe do t'u komunikohen autoriteteve kompetente në vijim të trasimit topografik që do të kryhet përpara operacioneve gjeofizike.




Figura 2: Shembull i operacioneve të vrojtimit gjeofizik me teknikën e vibrimeve





Figura 3: Shembull i operacioneve të vrojtimit gjeofizik me lëndë plasëse

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 8 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	--------------------------

Operacionet e projektit mund të ndahen në dy faza kryesore: Faza e para-vrojtimit dhe Faza e vrojtimit. Këto aktivitete ndahen më tej në hapa të njëpasnjëshëm si më poshtë:

- **Faza para-vrojtimit:**
 - a. Aprovimi mjedisor
 - b. Rikonjicioni i zonës
 - c. Mobilizimi.
- **Faza e vrojtimit:**
 - a. Marrja e lejes së aksesit & Kompensimi
 - b. Trasimi topografik i linjave
 - c. Pastrimi i bimësisë në linjat e vrojtimit
 - d. Shpimi i puseve të plasjeve
 - e. Vendosja i paisjeve në tokë
 - f. Vibruesit dhe Rregjistrimi
 - g. Plasja dhe rregjistrimi
 - h. Rehabilitimi i linjave

Secili nga këta hapa përshkruhet në detaje në Draft VNMS.


Procesi i VNMS-së dhe aprovimit mjedisor, i cili nisi me dorëzimin e Raportit të përcaktimit të çështjeve, dhe vijon me këtë draft VNMS, do të kryhet përpara mobilizimit për vrojtimin gjeofizik në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe procedurën e miratimit mjedisor.

Mobilizimi do të fillojë pas marrjes së aprovimit mjedisor dhe lejeve të tjera përkatëse dhe do të përfshijë planifikimin e MSHS, mobilizimin e ekipeve dhe paisjeve e makinerive si dhe, vendosjen e kampeve bazë dhe atyre fushorë dhe magazinave të ruajtjes së lëndëve plasëse. Termi "marrje e lejes" në vrojtimin gjeofizik përdoret për të përshkruar procesin e dakordësimit të lejes dhe marrëveshjeve për të hyrë në toka dhe për të siguruar kompensimin e mundshëm të pronarëve të tokës për çdo shqetësim (p.sh. në struktura, të mbjella etj.).

Ekipi i trasimit topografik do të kryejë një vrojtimit rikonjicioni të detajuar përgjatë çdo linje gjeofizike të propozuar dhe rrugëve të aksesit për të caktuar pozicionet e marrësve/gjeofonëve dhe puseve plasës ose vibruesve duke respektuar edhe distancat e përcaktuara të shmangies nga receptorët e ndjeshëm socialë dhe mjedisorë. Çdo rrezik i pidentifikuar më parë do të regjistrohet dhe linja do të zhvendoset.

Për të dy metodat, në disa zona mund të nevojitet pastrimi i vegjetacionit për të lejuar që operatori të ketë një pamje të qartë dhe për të krijuar akses të mjaftueshëm për automjetet dhe personelin që do të vendosë dhe do të largojë paisjet e vrojtimit gjeofizik. Pastrimi i vegjetacionit përgjatë linjave gjeofizike pritet të jetë minimal në varësi të llojit të bimësisë që do të ndërpritet dhe automjeteve për të cilat nevojitet akses. Nëse është e nevojshme, bimësia do të pritet deri në 10 cm lartësi nga niveli i tokës për të ruajtur rrënjët dhe ndihmuar rigjallërimin. Linjat e burimeve në të cilat do të shpohen pusët e plasjeve do të mbahet në një gjerësi minimale absolute, aq sa për të lejuar ecjen dhe vendosjen e pajisjeve të vrojtimit.

Pusët e plasjeve do të shpohen përgjatë Linjave të Burimeve, në një frekuencë prej 40 m. Thellësia e puseve të plasjeve vlerësohet të jetë përafërsisht 24 m dhe mund të zvogëlohet ose rritet në varësi të rezultateve të testeve të burimit që do të kryhen në terren në fillim të vrojtimit. Diametri i puseve të plasjeve vlerësohet të jetë 10 cm. Këto puse mund të nevojitet të çimentohen për të siguruar qëndrueshmërinë e vrimës së pusit. Do të shmangët shpimi i puseve plasës afër trupave ujorë dhe në rast ndërveprimi me ujërat nëntokësorë, që do të kuptohet nga

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 9 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	--------------------------

dalja e këtyre në sipërfaqe (ujëra artesianë), do të izolohet menjëherë dhe do të bëhet zhvendosja e pikës së shpimit. Çdo zonë shpimi do të rrethohet si zonë pune dhe pajiset me shenja sinjalizuese si flamuj dhe tabela paralajmëruese. Vetëm punonjës të trajnuar dhe të pajisur me veshje mbrojtëse do të lejohen në këtë zonë. Pasi shpohen pusët e plasjeve, në sipërfaqe përgjatë linjave të rregjistrimit, çdo 20 m do të vendosen rreshtime lineare prej 24 gjeofonësh të lidhur me bokset shumëfishues me kabëll ose me kamionin rregjistruar me sistem pa kablo.



Figura 4: Shpim i puseve plasës me sonda shpimi portative (majtas); Kamion vibrues (djathtas). (Burimi: Eni)

Metoda me vibrim për regjistrimin e të dhënave gjeofizike përdor një qasje tërësisht të ndryshme ndaj burimeve të energjisë me impulse. Në vend të dhënies së të gjithë sasisë në një interval shumë të shkurtër kohe, vibruesit shkaktojnë një radhë dridhjesh të njëpasnjëshme frekuenca e të cilave ndryshon gradualisht derisa të jetë arritur madhësia e parashikuar e saj.

Kjo metodë prodhon dridhje të kontrolluar e cila mund të përdoret në zona ku është e vështirë të përdoren lëndë plasëse dhe/ose kushtet mjedisore ose të sigurisë nuk janë të përshtatshme për përdorimin e lëndëve plasëse ose shpimin e puseve të plasjeve. Gjithsesi kamionët vibrues mund të jenë të përmasave shumë të mëdha dhe operimi i tyre kërkon mundësi shumë të mira aksesit në zonë.

Pasi gjeofonët të janë vendosur, energjia lëshohet për të gjeneruar një dridhje ose përmes përdorimit të lëndës plasëse të gëpësuar ose duke përdorur kamionin vibrues.

Pas lëshimit të energjisë, gjeofonët do të mblidhen dhe kushtet e zonës do të vlerësohen, dhe nëse është e nevojshme, do të rikthehen në gjendjen e para-vrojtimit.

Programi i vrojtimit gjeofizik 2D parashikohet të fillojë në Maj 2022 dhe të zgjasë deri në mes të Dhjetorit 2022, duke përfshirë rehabilitimin e linjave siç tregohet në kohëzgjatjen e projektit më poshtë (Tabela 1). Faza përgatitore e para-vrojtimit ka nisur ndërsa mobilizimi i projektit pritet të fillojë në Dhjetor 2021, duke pasuar fazën e marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe kryerjen e rikonzicionit të zonës (skauting).

Aktivitetet e fazës së vrojtimit që do të nisin me Marrjen e lejes për aksesin në toka & kompensimin pritet të fillojnë në Janar 2022, ndjekur nga Trasimi topografik i linjave në Shkurt 2022.

Aktivitetet në terren të tilla si Pastrimi i linjave të vrojtimit nga bimësia dhe Shpimi i puseve të plasjeve parashikohet të fillojnë në Mars 2022.

Operacionet do të përparojnë në mënyrë të njëpasnjëshme, duke lëvizur nga një zonë në tjetrën dhe nuk do të shpërndahen në të gjitha korridoret e studimit gjeofizik në të njëjtën kohë.



	Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 10 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------

Tabela 1: Kohëzgjatja e projektit sipas fazave

Fazat	2021											2022											
	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj	Jan	Shk	Mar	Pri	Maj	Qer	Kor	Gus	Sht	Tet	Nën	Dhj
Faza përpara fillimit të vrojtimit																							
Marrja e lejes	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■													
Rikonjicioni i zonës		■	■			■																	
Mobilizimi											■	■											
Aktivitetet e vrojtimit gjeofizik																							
Marrja e lejes së aksesit & Kompensimi												■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■	■
Trasimi topografik i linjës													■	■	■	■	■	■	■	■	■		
Pastrimi i bimësisë në linjat e vrojtimit														■	■	■	■	■	■	■	■		
Shpimi i puseve të plasjeve															■	■	■	■	■	■	■	■	
Vendosja e pajisjeve në tokë																■	■	■	■	■	■	■	
Vibruesit dhe rregjistrimi																■	■	■	■	■	■	■	■
Plasja dhe Rregjistrimi																■	■	■	■	■	■	■	■
Rehabilitimi i linjave																	■	■	■	■	■	■	■

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>11 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

3 ANALIZA E ALTERNATIVAVE

Një analizë e alternativave të mundshme është kryer në Draft VNMS për të përcaktuar fizibilitetin e Projektit Teknik të vrojtimit gjeofizik dhe për të garantuar që për projektin do të përdoren variantet më të përshtatshme të teknologjisë dhe menaxhimit.

Draft VNMS-ja shqyrton përshtatshërinë teknike dhe financiare të alternativave për arritjen e objektivave të projektit, nëpërmjet adresimit të:

- alternativës pa projekt;
- zonës së vrojtimit sizmik;
- metodës së përvetësimit të informacionit sizmik (përfshirë teknologjinë dhe përzgjedhjen e lëndës plasëse);
- aksesit në zonë;
- logjistikës dhe akomodimit; dhe
- mbetjeve.

4 KUSHTET BAZË TË MJEDISIT

Të dhënat për gjendjen e mjedisit në zonën e studimit përfaqësojnë një komponent thelbësor, i cili synon të sigurojë një pikë referimi përkundrejt së cilës ndikimet e mundshme mund të vlerësohen dhe monitorohen.

Karakteristikat mjedisore dhe sociale të zonës së studimit janë përshkruar bazuar në një kombinim të studimit të literaturës, i plotësuar nga vrojtimit në terren (studimet e kushteve bazë) të ndërmarra në Maj 2021, në pika të përzgjedhura përgjatë linjave gjeofizike dhe përmes intervistave me palët e interesit dhe komunitetin.

Figurat e mëposhtme tregojnë zonën e studimit të identifikuar për komponentët mjedisorë (**Error! Reference source not found.**) dhe komponentët socialë (Figura 6).




Figura 5: Zona e studimit mjedisor





Figura 6: Zona e studimit social

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 14 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

4.1 Kushtet bazë të mjedisit fizik

Kushtet bazë mjedisore dhe sociale janë përgatitur bazuar në burimet kombëtare dhe ndërkombëtare të të dhënave. Përveç informacionit të disponueshëm, u kryen vrojtime të kushteve bazë dhe u zhvilluan konsultime me autoritetet lokale për të konsoliduar dhe konfirmuar gjetjet e vrojtimeve.

Një përmbledhje e kushteve bazë të komponentëve në zonën e studimit është dhënë më poshtë, ndërkohë që informacionet dhe hartat e hollësishme do të paraqiten në Draft raportin e plotë të VNMS -së.

Klima dhe cilësia e ajrit

Sipas Beck et al. (2018), zona e studimit bie përfshihet në rajonin me klimë të butë, me verë të thatë dhe të nxehtë (Csa, sipas sistemit klimatik të Köppen), përveç një pjese të vogël në këndin juglindor, e cila kategorizohet si e butë me verë të thatë dhe të ngrohtë (Csb, sipas sistemit klimatik të Köppen). Janari, në përgjithësi, është muaji më i ftohtë me temperatura mesatare që variojnë midis 1°C dhe 8°C në varësi të lartësisë dhe kushteve lokale. Gushti është muaji më i nxehtë, me një temperaturë mesatare rreth 20-25°C. Sasia më e lartë e reshjeve (rreth 70%) është regjistruar gjatë muajve të ftohtë dhe arrin kulmin në nëntor, ndërsa reshjet më të ulëta në korrik-gusht. Reshjet e borës mund të ndodhin në zonën e studimit, por është një ngjarje e rrallë.

Aktualisht, receptori më i ndjeshëm në lidhje me cilësinë e ajrit brenda zonës së studimit është qyteti i Elbasanit (më i ekspozuari ndaj industrisë dhe trafikut), i ndjekur nga qytetet që vuajnë ndotjen e ajrit nga shërbimet e transportit. Në periferi të Elbasanit gjendet një ndër zonat kryesore industriale të Shqipërisë. Bashkitë e tjera që përfshihen në zonën e projektit kanë një profil më bujqësor, pa ndonjë aktivitet të rëndësishëm industrial. Menaxhimi i barërave të këqija përmes djegies është një praktikë tradicionale, zjarret në pyje, shkarkimet në ajër nga djegia e druve për zjarr në fshatra dhe, shkarkimet e makinerive bujqësore përbëjnë burimet kryesore të ndotjes së ajrit në zonat rurale dhe qendrat e banuara në zonën e studimit. Përveç kësaj, receptorët kryesorë të ekspozuar ndaj zhurmës përfshijnë qytezat dhe periferitë industriale të Elbasanit (Njësia administrative Bradashesh) dhe qendrat e banuara që ndodhen përgjatë rrugëve kryesore të transportit, veçanërisht segmentit rrugor nga Elbasani në qytetin e Rrogozhinës. Informacioni mbi vibrimet (dridhjet) në zonën e studimit nuk është i disponueshëm dhe nuk është pjesë e asnjë program institucional monitorimi.


Gjeologjia dhe Gjeomorfologjia

Zona e studimit ndodhet kryesisht brenda zonës Joniane, ndërsa pjesa më verilindore e saj shtrihet në zonën e Krutës dhe ajp perëndimore në Ultësirën PranAdriatike. Zona e Jonike zë një sipërfaqe të madhe dhe përfshin një gamë të gjerë shkëmbinjsh dhe depozitimesh sedimentare, nga ato më të vjetrat e moshës Triasike të Vonë deri te molasat e Pliocenit. Në veçanti, zona e interesit përbëhet nga depozitimet flishore të Oligocen-Miocen I poshtëm me një porcion të vogël evaporitësh të Permo-Triasikut të hershëm. Evaporitet e Dumresë zhvishen në qendër të një diapiri (Parise et al. 2008¹).

Rajoni i Dumresë është ndër zonat e prekura nga fundosja tektonike që vjen si pasojë e evolucionit neo-tektonik të Shqipërisë, karakterizuar nga një ngritje e përgjithshme që filloi në kohën e Pliocenit (Aliaj et al., 2001²). Lëvizjet vertikale që ndodhën që nga Pleistoceni i Mesëm

¹ Parise, M. & Qiriaz, Perikli & Sala, Skender. (2008). Evaporite karst of Albania: Main features and cases of environmental degradation. Environmental Geology. 53. 967-974. 10.1007/s00254-007-0722-x

² Aliaj, S., Baldassarre, G. & Shkupi, D. Quaternary subsidence zones in Albania: some case studies. Bull Eng Geol Env 59, 313-318 (2001)

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>15 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

u bënë shkak për formimin e strukturave të grabenit, shumë prej të cilave aktualisht janë të zëna nga liqene ose fusha.

Sipas hartës sizmike të Shqipërisë dhe "Kodit Sizmik të Projektimit KTP - 2 - 89" shqiptar, botuar nga Instituti Sizmologjik i Tiranës, zona e studimit vlerësohet me intensitetet 7-9 shkallë (MSK-64) (Sulstarova et al. 1980³).

Zona e studimit karakterizohet nga një përzierje e ultësirës (pjesë e zonës bregdetare) dhe kodrave të gjera para-alpine, me shpate më të pjerrët në pjesën veriore. Lartësia e pasqyron këtë prirje, me zonën më të ngritur në lindje dhe veri, rrafshnaltën e Dumresë në qendër, dhe ultësirën në perëndim dhe jug, pranë Elbasanit dhe në korrelacion me lumenjtë kryesorë.

Karakteristikat e dobëta fiziko-mekanike të evaporiteve japin mundësinë që rrjeti karstik të mbyllet nga evaporitet e shembur dhe, si rezultat i kësaj, formohet depresion në sipërfaqen e tokës. Në zonat kodrinore, ku nuk ka bimësi dhe toka e zhveshur është e ekspozuar, ka dukuri të konsiderueshme të paqëndrueshmërisë së shpateve dhe dukurive të përshpejtuara të erozionit.

Tokat

Nga viti 1950 deri në 1990, klasifikimi i tokës u bazua në lartësinë, kushtet klimatike dhe bimësinë natyrore. Bazuar në këtë sistem, zona e studimit mbizotërohet nga llojet e tokave livadhore të kuqërremta në pjesën lindore dhe të kuqërremta në gri në pjesën perëndimore (Harta e tokave të Shqipërisë 1958). Pas viteve 90 sistemi i klasifikimit të tokës u orientua drejt klasifikimit ndërkombëtar të tokës. Një studim i posaçëm⁴ për klasifikimin e tokave në Shqipëri, bazuar në sistemin Botëror të Referencës për Burimet e Tokës, tregon se zona e studimit mbizotërohet nga lloje të tokës si nëntipet e Luvisols si: Luvisol Haplic i ndjekur nga Luvisole Vertic dhe Luvisole Chromic.

Shkalla e erozionit të tokës në Shqipëri është rritur pas vitit 1990 për shkak të ndryshimeve dramatike të përdorimit të tokës, shpyllëzimeve të pakontrolluara dhe të paligjshme, ndryshimit të klimës dhe kullotjes së tepërt. Në zonën e studimit, zonat më të prirura për erozion përfshijnë kodrat përgjatë pjesëve veriore dhe lindore të saj (Qarku i Tiranës dhe Elbasanit)

Burimet ujore


Zona e studimit ndodhet kryesisht në basenin e lumit Shkumbin, përveç pjesëve juglindore dhe jugore që përfshihen në basenin e lumit Seman.

Rrjeti hidrografik i pellgut ujëmbledhës të Shkumbinit përbëhet nga një numër i madh përrenjsh dhe përrenjsh të vegjël deri në degët e tij kryesore, siç janë përrenjtë e Radinicës, Bushtricës, Gostimës, Rrapunit, Zaranikës. Disa nga këto degë përshkojnë zonën e studimit si përrenjtë e Gostimës, Rrapunit, Zaranikës. Regjimi i prurjes është sezonal. Gjatë periudhës së lagësht (tetor - maj) prurja është më e lartë se prurja e përgjithshme vjetore dhe gjatë periudhës së thatë është më e ulët se prurja e përgjithshme vjetore. Fluksi maksimal arrihet gjatë marsit dhe prillit, kur është rreth 15% më i lartë se fluksi i përgjithshëm vjetor. Prurja minimale është vërejtur në gusht, kur është rreth 1.2-1.9% më e ulët se prurja e përgjithshme vjetore⁵. Ujërat e lumit Shkumbin kanë një nivel mesatar mineralizimi, të mbizotëruar nga bikarbonatet.

³ Sulstarova E., Koçiu S., Aliaj Sh., 1980, Seismic zonation of Albania, Publication of Seismological Center of Academy of Sciences, Tirana, Albania, pp. 297

⁴ Zdruli P., Lushaj S., Pezzuto A, Fanelli D., D'Amico O., Filomeno O., DeSantis S., Todorovic M., Nerilli E., Dedaj K., Seferi B. Preparing a geo-referenced soil database for Albania at scale 2:250,000 using the European soil bureau manual of procedures 1.1. In: Zdruli P. (ed.), Steduto P. (ed.), Kapur S. (ed.). *7. International meeting on Soils with Mediterranean Type of Climate (selected papers)*. Bari: CIHEAM, 2002. p. 135-144 (Options Méditerranéennes : Série A. Séminaires Méditerranéens, n. 50).

⁵ EuropeAid/135700/DH/SER/AL, IBECA (2017) Shkumbini River Basin Management & Climate Change Adaptation Plan

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>16 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

Raporti i Gjendjes së Mjedisit 2019 i klasifikon ujërat e basenit të lumit Shkumbin si të Klasës III – Cilësi e moderuar.

Lumi Seman formohet nga dy degë kryesore: Devolli dhe Osumi të cilat takohen pranë qytetit të Kuçovës. Lumi Seman raportohet të ketë ndryshueshmërinë më të lartë të rrjedhës për çdo lumë në vend. Përafërsisht rreth 60% e ujit sigurohet nga zona e pellgut ujëmbledhës Devolli.

Lumi Devolli, i cili rrjedh pjesët lindore dhe jug-lindore të zonës së studimit, ushqehet kryesisht nga ujërat sipërfaqësorë⁶. Rrjedha e këtij lumi pasqyron ndryshimet sezonale të reshjeve; përrrenj në dimër dhe gati të thatë gjatë muajve të verës.

Zona e studimit ndodhet në rajonin e Dumresë, një nga tiparet kryesore të të cilit është numri i madh i liqeneve. Këto liqene janë të përhapura, por përqendrimi më i lartë është përgjatë një brezi të gjerë 4 km, që ka një shtrirje pothuajse si vazhdimi i luginës së Elbasanit. Sipërfaqja e përgjithshme e të gjithë liqeneve të Dumresë është afërsisht 645 ha, që përbën rreth 3% të sipërfaqes totale të të gjithë rajonit. Stabiliteti i vëllimit të ujit në liqene varet kryesisht nga regjimi i reshjeve dhe marrëdhëniet midis madhësisë së pellgut ujëmbledhës dhe sipërfaqes së liqenit, me përjashtim të Liqenit të Belshit. Kjo është arsyeja pse në periudhën e thatë të vitit, disa liqene të vegjël thahen, ndërsa në ato më të mëdha, uji është i pranishëm gjatë gjithë vitit. Asnjë nga aktivitetet e projektit nuk do të zhvillohen brenda ose në kufi të liqeneve.

Pjesa më e madhe e zonës së studimit vendoset mbi depozitimet e trasha aluviale me zhavorr të luginës së lumit Shkumbini dhe ujëmbajtësit në bregun e majtë, nga lumi në Lushnje.

Depozitimet e trasha aluviale me zhavorr të luginës së lumit Shkumbini, veçanërisht në fushën e Elbasanit, kanë përgjithësisht përçueshmëri të lartë dhe formojnë akuifere të bollshëm porozë me cilësi të mirë uji. Akuiferi është kryesisht i papërcaktuar dhe i lidhur mirë me ujërat sipërfaqësorë. Kapaciteti maksimal i puseve në fushën e Elbasanit është më shumë se 100 l/s, dhe në luginën e lumit Shkumbini, pranë Peqinit, është rreth 30 l/s. Në mënyrë të ngjashme, si për të gjithë vendin, ujërat nëntokësore përfaqësojnë burimin e vetëm të ujit si për konsum njerëzor ashtu edhe për përdorime industriale (të kapura në burime ose të pompuara nga puse) në Zonën e Studimit. Uji ka një cilësi të mirë dhe nuk kërkon ndonjë trajtim dytësor: dezinfektimi (me klorim) është i mjaftueshëm.⁷

Pjesa jugore e zonës së studimit shtrihet mbi akuiferin e luginës së Beratit. Lugina e Beratit, për sa i përket hidrogeologjisë, përbën një pellg ujëmbajtës me rezerva të konsiderueshme të ujërave nëntokësore. Rendimenti i tij është i mjaftueshëm për furnizimin me ujë lokal, por cilësia e ujit është e dobët dhe vështirë se i plotëson standardet kombëtare të ujit.


4.2 Kushtet bazë të mjedisit biologjik

Zona e studimit mbështet një sërë llojesh dhe habitatesh natyrore, gjysmë natyrore dhe artificiale. Habitatet e modifikuara, veçanërisht ato që përdoren intensivisht si tokat bujqësore, përbëjnë shumicën e habitateve të tanishme (57,82%), ndërsa habitatet natyrore (42,18%) përfaqësohen kryesisht nga makie dhe pyje të degraduara, të mbizotëruara nga dushku gjetherënës (kryesisht në pjesët lindore dhe veriore të zonës së studimit që korrespondojnë me zonat malore) dhe më pak nga rripat bregdetarë përgjatë rrjedhave ujore të tilla si lumi Shkumbin dhe Devoll.

Sipas të dhënave bazë, zona e studimit strehon 218 lloje bimësh, nga të cilat 17 specie konsiderohen me interes për ruajtjen.

⁶ MARD Preparation of River Basin Management Plans for Drini-Buna and Semani AOBWs, Semani Final River Basin Management Plan June 2019

⁷ EuropeAid/135700/DH/SER/AL, IBECA (2017) Shkumbini River Basin Management & Climate Change Adaptation Plan

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>17 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

Zona e studimit gjithashtu strehon 286 lloje të faunës, nga të cilët një numër konsiderohet i kërcënuar dhe/ose i mbrojtur bazuar në Listën e Kuqe Ndërkombëtare të IUCN, Listën e Kuqe Shqiptare (2013) dhe në Direktivat e Shpendëve dhe Habitaveve, si më poshtë:

- 3 peshq
- 5 amfibë
- 19 reptilë
- 50 shpendë
- 33 gjitarë (kryesisht lakuriqët)
- 1 insekt
- 12 lepidoptere
- 6 koleoptere
- 1 molusk

Brenda zonës së studimit gjenden 21 monumente natyre, një kategori e veçantë e zonave të mbrojtura në Shqipëri. Megjithatë, Monumentet e natyrës nuk do të ndërpriten nga linjat gjeofizike sepse do të shmangen tërësisht (d.m.th. gjurmët e linjave gjeofizike do të shmangen nga zona buferike prej 200 m ndaj monumenteve të natyrës). Gjithashtu në zonën e studimit janë të pranishme dy zonatë mbrojtura të propozuara:

- Parku i propozuar Rajonal Grekan: i cili ndërpritet nga linjat e burimeve rreth 1,5 km;
- Parku i propozuar Rajonal Thanë: i cili ndërpritet nga linjat e burimeve rreth 500 m dhe nga linjat e marrësve rreth 200 m.

Parku Kombëtar i Dajtit (Kategoria II) gjendet jashtë zonës së studimit në verilindje të saj dhe nuk do të preket nga projekti.

4.3 Kushtet bazë të mjedisit social

Zona e studimit shtrihet kryesisht me territorin e Qarkut Elbasan përveç pak kilometrave në Bashkinë Lushnje (Qarku Fier), Bashkinë Tiranë (Qarku Tiranë) dhe Bashkinë Kuçovë (Qarku Berat). Shtatë bashki (Elbasan, Cërrik, Belsh, Peqin, Lushnje, Tiranë dhe Kuçovë) dhe 29 Njësi administrative përfshihen në zonën e studimit.

Popullsia rezidente përbëhet kryesisht nga shqiptarët duke ndryshuar nga 77.71% në Fier në 85.58% në Elbasan. Ka gjithashtu pakica etnike të ndryshme si greke, maqedonase, arumune, rome dhe egjiptiane, por ata përfaqësojnë më pak se një përqind në qarqet në zonën e studimit.


Punësimi lokal

Burimi kryesor i punësimit brenda zonës së studimit janë fermat familjare që përfshijnë dhe mbarështimin e bagëtive. Punësimi në qytete është kryesisht në institucionet shtetërore dhe industrinë e shërbimeve, me turizmin që vitet e fundit gjithashtu po bëhet një aktivitet i rëndësishëm për punësim. Ndonëse Bashkia Elbasan ka në territorin e saj një pjesë të madhe të industrisë së rëndë të Shqipërisë, industrinë e mbijetuara aktualisht punësojnë vetëm disa mijëra banorë duke lënë pjesën tjetër të popullsisë të papunë.

Përdorimi i tokës dhe pronësia mbi tokën

Të dhënat e Mbulesës së Tokës Corine tregojnë se brenda zonës së studimit mund të priten të ndodhin llojet e mëposhtme të përdorimit të tokës:

- Fermat bujqësore me prodhime të ndryshme.
- Terrenet për bagëtinë përfshirë përdorimin e kullotave natyrore.
- Rritjen dhe mbledhjen e bimëve barishtore për bagëtinë nga kullota dhe zona të tjera.
- Përdorimin e pyjeve për rekreacion dhe mbledhjen e druve.

	Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 18 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------

Në zonën e studimit të mjedisit social, pronësia mbi tokën nuk është e përcaktuar qartë. Në disa raste, fshatarët kanë aplikuar për marrjen e saj, por në shumicën e rasteve as që kanë aplikuar për këtë. Kjo çështje lidhet kryesisht me kostot e marrjes së certifikatës së tokës, procedurat e gjata dhe vështirësitë e njerëzve për t'i rregulluar ato sepse disa janë emigrant dhe është e vështirë të ndjekin procedurat për shkak të mungesës së disponueshmërisë. Familjet shpesh zotërojnë disa parcela toke të shpërndara në një zonë të gjerë⁸.

Aktiviteti ekonomik

Bujqësia duket se është sektori më i rëndësishëm ekonomik në zonën e studimit. Megjithatë, ka disa industri të rënda brenda zonës së studimit përfshirë uzinën e çelikut, atë të prodhimit të çimentos, përpunimit të ferrokromit etj. në Bashkinë Elbasan dhe, nxjerrjen e naftës në zonën e Kuçovës.

Turizmi

Turizmi është identifikuar tashmë si një aktivitet alternativ i rëndësishëm ekonomik në zonën e projektit, duke siguruar diversifikim nga ekonomia bujqësore tradicionale. Falë vlerave të tij të larmishme turistike të përfaqësuara ndër të tjera nga rreth 100 destinacione të trashëgimisë historike dhe kulturore dhe rreth 80 monumente natyrore të përhapura në të gjithë rajonin, Elbasani po bëhet një destinacion i rëndësishëm turistik. Turizmi është një nga drejtimet më premtuese të zhvillimit ekonomik për Bashkinë Belsh.

Infrastruktura rrugore

Në zonën e studimit ka një sërë llojesh rrugësh, duke përfshirë: Rrugë parësore rajonale që lidhin qytetet kryesore, p.sh. Elbasanin me Lushnjën; Rrjeti i rrugëve dytësore dhe terciare dhe të shërbimit që lidhin komunitetet e qytetit dhe fshatit, duke përfshirë disa rrugë në rajonet malore; dhe rrugë hyrëse të pashtuara për në ato fshatra larg rrugëve kryesore, në lugina dhe në fushat bujqësore. Këto rrugë janë zakonisht në gjendje të keqe me çarje të thella dhe pjerrësi të madhe, të kalueshme vetëm nga automjetet me katër rrota. Ata janë me një korsi të vetme, me mundësi të kufizuara për të kaluar. Udhëtimi përgjatë këtyre rrugëve është i ngadalshëm.

Asgjësimi i mbetjeve dhe ujërave të zeza

Grumbullimi i mbetjeve në të gjitha bashkitë e zonës së studimit kryhet nga disa nënkontraktorë lokalë të kontraktuar nga secila bashki. Këto kompani janë përgjithësisht të vogla dhe kryejnë pastrimin e kazanëve të mbetjeve dhe transportimin e mbetjeve në vendet e caktuara të depozitimit. Ndonëse në Shqipëri ka disa kompani riciklimi operacionale (të përqendruara në riciklimin e metaleve, plastikës dhe ambalazheve prej letre),⁹ në bashkitë e zonës së studimit nuk ka ende një sistem të ndarjes në burim të mbetjeve dhe riciklimit. Ka një shërbim të veçantë privat për trajtimin e mbetjeve spitalore.

Në Elbasan ka një incinerator që operon me gjysëm kapaciteti. Impianti që djeg mbetjet duke i shndërruar në energji krijon të ardhura ndërkohë që trajton çështjen e depozitimit të mbetjeve në vend.¹⁰

Në zonën e projektit nuk ka asnjë implant të trajtimit të ujërave të ndotur. Ujërat e ndotur shkarkohen direkt në lumë të patrajtuar. Impianti më i afërt i trajtimit të ujërave të ndotur gjendet në qytetin e Kavajës.


Trashëgimia kulturore

Zona e studimit shtrihet gjerësisht në rajonin e Elbasanit. I pozicionuar në Shqipërinë e Mesme dhe në një korridor rrugor strategjik, ky rajon ka qenë i rëndësishëm për tregtinë, transportin

⁸ Komunikime personale me departamentet e bashkive, 17 Maj 2012 (ekipi lokal i VNMS-së)

⁹ Albanian Recyclers Association members available at http://www.ara.org.al/?page_id=12 (Accessed June 13, 2021).

¹⁰ Exit explains: Albania's three waste incinerators, Exit article, 12-10-2020, available at <https://exit.al/en/2020/10/12/exit-explains-albanias-three-waste-incinerators/> (Accessed June 13, 2021).

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>19 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

dhe ushtrinë. Trashëgimia kulturore e zonës së projektit përfshin monumente kulture të shpallur, zona të mbrojtura dhe trashëgimi jo-materiale. Ka një numër ngjarjesh kulturore që zhvillohen për pupullsinë lokale dhe turistët. Disa janë ngjarje të rregullta të përvitshme që zhvillohen pothuajse në të njejtën periudhë të vitit dhe disa janë ngjarje të njëhershme. Trashëgimia kulturore e paklasifikuar por që mund të gjendet në zonën e projektit gjithashtu është hartëzuar dhe paraqitur në raportin e VNMS së thelluar. Në zonat e trashëgimisë kulturore nuk do të zhvillohet asnjë operacion. Gjatë operacioneve të projektit do të zbatohet një procedurë e gjetjeve rastësore.

5 METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT

Metodologjia e vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe social e përdorur në studimin e paraqitur përmbush standardet dhe kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare.

Informacion mbi karakteristikat e veprimtarisë së vrojtimit gjeofizik-2D dhe përshkrimi i kushteve bazë të mjedisit janë përdorur për të identifikuar dhe vlerësuar rëndësinë e ndikimeve të mundshme pozitive dhe negative të krijuara nga vrojtimi gjeofizik- 2D në kontekstin mjedisor, social, kulturor dhe shëndetësor. Pasi të identifikohen dhe vlerësohen ndikimet, duhet të përcaktohen masat lehtësuese dhe përmirësuese në mënyrë që të shmangen dhe më tej të zvogëlohen, rehabilitohen dhe mundësisht të kompensohen ndikimet negative të identifikuara, duke rritur ato që janë pozitive.

Sipas metodologjisë së Eni, vlerësimi i ndikimit kryhet përgjatë tre hapave të paraqitur në vijim në Figura 7.




Figura 7: Metodologjia e vlerësimit të ndikimit

Pasi të vlerësohen ndikimet e mundshme të identifikuara, rëndësia e secilit ndikim (pozitiv ose negativ) është vlerësuar me një matricë llogaritëse që kombinon **madhësinë e ndikimeve të mundshme** (presionet e projektit) përkundër **ndjeshmërisë së receptorit/burimeve**.

Madhësia e ndikimeve është një kombinim i kohëzgjatjes, shtrirjes dhe shkallës ndërsa ndjeshmëria e burimit/receptorit është një kombinim i rëndësisë/vlerës dhe cënueshmërisë/aftësisë përtëritëse. Të dyja, madhësia dhe ndjeshmëria e burimit/receptorit janë renditur sipas klasave në vijim siç tregohet në tabelën më poshtë.

Tabela 2. Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve mbetëse

Rëndësia		Ndjeshmëria e burimit / receptorit		
		I ulët	Mesatar	I lartë
Madhësia e ndikimit	I papërfillshëm	I ulët	I ulët	I ulët
	I vogël	I ulët	Mesatar	I lartë
	Mesatar	Mesatar	I lartë	Kritik
	I madh	I lartë	Kritik	Kritik

Pasi të identifikohen dhe vlerësohen ndikimet, duhet të përcaktohen masat lehtësuese dhe përmirësuese në mënyrë që të shmangen dhe më tej të zvogëlohen, rehabilitohen dhe mundësisht të kompensohen ndikimet negative të identifikuar, duke rritur ato që janë pozitive.

Error! Reference source not found. tregon qasjen që duhet ndjekur për identifikimin e masave zbutëse.




Figura 8: Kuadri i hierarkisë zbutëse

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 21 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

6 VLERËSIMI I NDIKIMIT MJEDISOR

Gjeologjia dhe Gjeomorfologjia


Ndikimet e mundshme kryesore të vrojtimit gjeofizik në gjeologji, si duke përdorur teknikat e vibrimit ashtu edhe teknikën e puseve plasës pritet të jenë:

- Dëmtim i shpatit shkaktuar nga emetimi i vibrimeve. Burimi me vibrime prodhon valë energjie duke vibruar një masë të një madhësie të caktuar, ndërsa teknika me puse plasëse prodhon valë duke shpërthyer një ngarkesë të vogël të vendosur në një pus të cekët të shpuar në tokë. Kur operacionet e përmendura kryhen pranë shpateve të pjerrët ose pranë zonave me rrëshqitje ekzistuese së tokës, kjo mund të çojë në rrëshqitje të vogla dhe rënie shkëmbinjsh ose në riaktivizim të fenomeneve ekzistuese të paqëndrueshmërisë, nëse kushtet e stabilitetit janë afër kufirit të ekuilibrit.
- Ndryshimi i morfologjisë sipërfaqësore. Morfologjia sipërfaqësore mund të ndryshojë nga nivelimi i tokës për krijimin e gjurmëve të linjave të vrojtimit dhe vendosjen e pikave të shpimit. Në zonat e shqetësuara mund të shkaktohen dukuri të përshpejtuara të erozionit dhe dëmtim i shpatit nëse nuk menaxhohen siç duhet.

Masat zbutëse të propozuara

- Linjat gjeofizike do të devijohen (gjatë trasimit topografik) për të shmangur zonat e rrëshqitjes së dheut dhe për të mbajtur një distancë sigurie prej tyre.
- Energjizimi në ose pranë shpateve më të pjerrët se 40° do të shmanget për të minimizuar rrezikun e rrëshqitjeve të tokës dhe rrëzimit të shkëmbinjve.
- Shmangia e aktivizimit të energjisë pranë sipërfaqeve ekzistuese të eroduara (p.sh., rrëke, gryka).
- Sheshimi dhe ngjeshja e tokës do të shmangen sa të jetë e mundur praktikisht.
- Shqetësimi i gjeomorfologjisë nga përgatitja e zonave të kalimit/vendosjes do të minimizohet sa më shumë që të jetë e mundur duke zgjedhur zona më të aksesueshme përgjatë korridorit të vrojtimit (p.sh., duke vibruar përgjatë rrugëve ekzistuese në vend të zonave natyrore ose tokave bujqësore).
- Çdo shpat që do të gërmohet dhe mbushet përgjatë rrugëve do të stabilizohet me teknikat e duhura të kullimit dhe kontrollit të erozionit për të parandaluar erozionin e përshpejtuar (rrjedhat, grykat) dhe dëmtimin e shpatit.
- Para operacioneve të shpimit dhe energjizimit do të kontrollohen kushtet e stabilitetit lokal të shpatit në përputhje me zonat e pikës së burimit, veçanërisht pas reshjeve intensive ose të zgjatura të shiut. Nëse vërehen dëshmi lokale të paqëndrueshmërisë, do të vlerësohet ri-pozicionimi i pikave (ve) burimore.
- Ngarkesa e lëndës plasëse do të jetë sa më e vogël e mundur (rreth 5 kg¹¹) për të shmangur krijimin e kraterit.
- Gjatë trasimit topografik do të identifikohen dhe vlerësohen rreziqe të tjera gjeologjike përkatëse (p.sh. zgavrat karstike, hinka), dhe nëse është e nevojshme linja gjeofizike do të devijohet.
- Trasimi topografik do të identifikojë zonat e rrezikshme që do të shënohen në hartat online. Këto zona do të evidentohen për punonjësit përmes një ose më shumë formave të identifikimit të rrezikut (sinjalistikë, flamur, harta, etj.).

¹¹ Mund të zvogëlohet ose të rritet deri në 8 kg në varësi të rezultateteve të testeve të burimit që do të zhvillohen në terren nga Kontraktori gjeofizik përpara fillimit të vrojtimit.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>22 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

- Toka përreth posit plasës duhet të rikthehet në gjendjen e saj origjinale.

Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në komponentin gjeologjik pritet të jenë të ulëta.*

Tokat


Ndikimet e mundshme kryesore të vrojtimit gjeofizik në tokë, si duke përdorur teknikat e vibrimit ashtu edhe teknikën e puseve plasës pritet të jenë:

- Ngjeshje/erozion i tokës. Ngjeshja dhe erozioni i tokës mund të shkaktohet nga lëvizja jashtë rrugës e pajisjeve dhe automjeteve të rënda dhe nga vendosja e platformave në zonat e shpimit. Erozioni i tokës gjithashtu mund të shkaktohet nga modifikimi i vegjetacionit natyror që lidhet me përgatitjen e zonave të kalimit/vendosjes për automjetet e vrojtimit.
- Përkeqësimi i cilësisë së tokës mund të shkaktohet nga derdhja aksidentale e karburantit ose lubrifikantit që mund të ndodhë si pasojë e mosfunksionimit ose dëmtimit të automjetit gjatë lëvizjeve ose operacioneve të energjizimit. Në mungesë të asfaltit të rrugës, lëngjet e derdhura mund të infiltrojnë drejtpërdrejt dhe të ndikojnë në cilësinë e tokës.

Masat zbutëse të propozuara

- Të gjitha rrugët dhe shtigjet ekzistuese (të asfaltuara ose jo) do të identifikohen gjatë trasimit topografik¹² dhe më pas do të përdoren sa më shumë të jetë e mundur gjatë operacioneve në mënyrë që të shmanget ose minimizohet qarkullimi jashtë rruge, pra shqetësimi i tokës dhe vegjetacionit.
- Pastrimi i bimësisë, vegjetacionit dhe të mbjellave do të shmanget ose minimizohet sa më shumë gjatë përgatitjes së traseve të linjave të vrojtimit, shpimit të puseve ose përgatitjes së zonave të vendosjes së marrësve.
- Shqetësimi i tokës nga përgatitja e zonave të kalimit/vendosjes do të minimizohet sa më shumë që të jetë e mundur duke zgjedhur zona më të aksesueshme përgjatë korridorit të vrojtimit (p.sh., duke kryer vibrime përgjatë rrugëve ekzistuese në vend të zonave natyrore ose tokave bujqësore).
- Shmangia e aktivizimit të energjisë pranë sipërfaqeve ekzistuese të eroduara (p.sh., rrëqe, gryka).
- Nëse kërkohet nivelimi, shtresa e sipërme e pasur me lëndë organike do të hiqet dhe grumbullohet në vende të përshtatshme për përdorim të mëvonshëm në restaurimin e zonave të prekura.
- Çdo shpat që do të gërmohet dhe mbushet përgjatë rrugëve do të stabilizohet me teknikat e duhura të kullimit dhe kontrollit të erozionit për të parandaluar erozionin e përshpejtuar (rrjedhat, grykat).
- Zona e zënë nga pajisjet e shpimit dhe ato ndihmëse do të mbahet në minimumin e mundshëm në mënyrë që të shmanget ose minimizohet ngjeshja/degradimi i tokës, shqetësimi i tokës dhe modifikimi i vegjetacionit/të korrave.
- Dizanjimi i zonave të shpimit dhe atyre të vendosjes së pajisjeve në mënyrë që të minimizohet shtrirja e tyre dhe rrjedhimisht për të zvogëluar ngjeshjen/degradimin e tokës, shqetësimin e tokës dhe modifikimin e vegjetacionit/të korrave.

¹² Është ekzekutuar si pjesë e rikonjcionit të terrenit të zhvilluar nga Eni (në prill) dhe nga kontraktorët gjeofizikë (në korrik) por do të përfundojë gjatë trasimit topografik.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 23 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

- Vetëm automjetet kryesore dhe gomat me presion të ulët/ndikim të ulët do të përdoren në zonat me tokë të lagësht ose që janë të priruara ndaj kënetizimit ose ndaj erozionit.
- Ekipi i trasimit topografik do të mbajë një regjistër për çdo rrezik të hasur (p.sh., tokë e lagësht/e butë) dhe do të informojë për to ekipin e vrojtimit gjeofizik.
- Të gjitha automjetet dhe makineritë që veprojnë në terren do të mirëmbahen në mënyrën e duhur për të parandaluar rrjedhjet e naftës që mund të ndotin tokën. Mjetet e pastrimit të derdhjes do të jenë në dispozicion për ndërhyrje të menjëhershme.
- Të gjithë shoferët dhe teknikët do të informohen në lidhje me procedurat e furnizimit me karburant, disqet e mbledhjes së derdhjeve dhe mjetet e pastrimit të derdhjeve, përmes trajnimit dhe bisedave periodike.
- Çdo ri-furnizim me karburant në terren i kamionëve vibrues, kamionëve regjistruar ose operacion mirëmbajtje do të kryhet duke përdorur disqet e mbledhjes së rrjedhjeve dhe derdhjeve dhe mjetet për pastrimin e tyre të disponueshme.
- Të gjitha lëndët djegëse dhe lëngjet e tjera të rrezikshme (p.sh., lubrifikantët) do të ruhen në kontenerë të përshtatshëm dhe të sigurt, sipas rregulloreve vendore¹³ dhe praktikave të mira ndërkombëtare.
- Për të shmangur çdo rrezik të ndotjes së tokës, nuk do të përdoret asnjë lëng shpimi me kimikate për shpimin e puseve. Do të përdoret vetëm ujë (pa aditivë). Nëse është e nevojshme, në disa raste argjila do të përzihet me ujë për të rritur qëndrueshmërinë e mureve të pusit.
- Në rast derdhjeje aksidentale, toka e ndotur do të hiqet menjëherë, do të grumbullohet siç duhet dhe do të menaxhohet si një mbetje e rrezikshme sipas rregulloreve vendore dhe gjithashtu duke ndjekur standardet e Eni-t.
- Eni do të përgatisë një Plan për reagimin ndaj emergjencave për të adresuar çdo ngjarje të mundshme, përfshirë derdhjet eventuale të naftës. Ekipi i vrojtimit gjeofizik do të trajnohet si duhet për të zbatuar Planin në rast të ndonjë aksidenti.
- Në fund të operacioneve, të gjitha zonat e shqetësuara do të pastrohen dhe do të rikthehen sa më shumë që të jetë e mundur në gjendjen e tyre të mëparshme. Shtresa e sipërme, nëse është hequr, do të rehabilitohet në mënyrë që të mundësojë ri-vegjetacion natyror. Zonat e ndikuara nga ngjeshja e tokës do të plugohen në mënyrë të përshtatshme.

Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.


Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në komponentin tokë pritet të jenë të ulëta.*

Hidrogjeologjia & cilësia e ujërave

Ndikimi i mundshëm kryesor i vrojtimit gjeofizik në ujërat nëntokësorë, si duke përdorur teknikat e vibrimit ashtu edhe teknikën e puseve plasës, pritet të jetë:

- Përkeqësimi i cilësisë së ujërave nëntokësore si rezultat i rrjedhjeve/derdhjeve aksidentale ose çlirimit të mbetjeve të lëndës plasëse. Emetimi i substancave ndotëse në ujërat nëntokësore mund të ndodhë në rast të derdhjes aksidentale të karburantit ose lubrifikantëve për shkak të mosfunksionimit ose dëmtimit të automjetit gjatë lëvizjeve ose operacioneve të energjizimit.

¹³ Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>24 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

Mundësia e ndotjes së ujërave nëntokësorë mund të jetë më e lartë në rast të derdhjes aksidentale nga pajisjet e shpimit sepse vrima e pusit mund të veprojnë si një rrugë preferenciale për lëngjet e derdhura potencialisht të ndotura.

Cilësia e ujërave nëntokësorë mund të përkeqësohet edhe në zonat ku fenomenet karstike janë të pranishme pasi rrjetet nëntokësore karstike mund të strehojnë akuiferë të rëndësishëm dhe të veprojnë si rrugë për migrimin e ndotjes.


Kampi bazë i përkohshëm gjithashtu mund të shkaktojë shkarkimin e ndotësve në ujërat nëntokësore në rast të derdhjes aksidentale të karburantit ose substancave të tjera të rrezikshme në zonat e magazinimit dhe mirëmbajtjes ose gjatë operacioneve të furnizimit me karburant. Cilësia e ujërave nëntokësore në kampin bazë të përkohshëm gjithashtu mund të ndikohet nga menaxhimi jo i duhur i ujërave të zeza.

Masat zbutëse të propozuara

- Lidhur me rrezikun e përkeqësimit të cilësisë së ujërave nëntokësore si rezultat i çlirimit të mbetjeve të lëndës plasëse, masa kryesore zbutëse është **shmangia**. Siç është thënë më parë, vibruesit do të jenë burimi i preferuar i energjisë në zonat fushore dhe brigjet e lumenjve, ku ndodhen shumica e akuifereve të cekët në zonën e projektit. Pusët e plasjes në përgjithësi do të kufizohen në zonat kodrinore/malore, ku niveli i ujit tenton të jetë më i thellë se thellësia e puseve të plasjes, duke shmangur kështu përkeqësimin e cilësisë së ujërave nëntokësorë.
- Ngarkesa e lëndës plasëse (Pentolite) do të jetë më e ulëta e mundshme (rreth 5 kg¹⁴) për të lejuar arritjen e objektivit gjeologjik të këtij projekti duke kufizuar në një sasi shumë të vogël mbetjet e shpërthimit.
- Sa herë që uji të rrjedh në sipërfaqen e pusit, shpimi do të ndalet dhe pusi do të mbyllet siç duhet sipas standardeve të Eni.
- Për të shmangur çdo rrezik të ndotjes së ujërave nëntokësorë, nuk do të përdoret asnjë lëng shpimi me kimikate për shpimin e puseve. Do të përdoret vetëm ujë (pa aditivë). Nëse është e nevojshme, në disa raste argjila do të përzihet me ujë për të rritur qëndrueshmërinë e mureve të pusit.
- Të gjitha automjetet dhe makineritë që veprojnë në terren do të mirëmbahen në mënyrën e duhur për të parandaluar rrjedhjet e naftës që mund të ndotin ujërat nëntokësorë. Mjetet e pastrimit të derdhjes do të jenë në dispozicion për ndërhyrje të menjëhershme.
- Të gjithë shoferët dhe teknikët do të informohen në lidhje me procedurat e furnizimit me karburant, disqet e mbledhjes së derdhjeve dhe mjetet e pastrimit të derdhjeve, përmes trajnimit dhe bisedave periodike.
- Në kampin bazë të përkohshëm, nuk do të ndodhë asnjë furnizim me karburant jashtë zonave të caktuara të karburantit/servisit, përveç se për arsye sigurie/sigurie ose emergjence.
- Çdo ri-furnizim me karburant në terren i kamionëve vibrues, kamionëve regjistruar ose operacion mirëmbajtje do të kryhet duke përdorur disqet e mbledhjes së rrjedhjeve dhe derdhjeve dhe mjetet për pastrimin e tyre të disponueshme.
- Të gjithë karburantet dhe lëngjet e tjera të rrezikshme (p.sh., lubrifikantët) do të ruhen në kontenerë të përshtatshëm dhe të sigurt, sipas rregulloreve vendore¹⁵ dhe praktikave të mira ndërkombëtare.

¹⁴ Mund të zvogëlohet ose të rritet deri në 8 kg në varësi të rezultateve të testeve të burimit që do të zhvillohen në terren nga Kontraktori gjeofizik përpara fillimit të vrotimit.

¹⁵ Ligji nr.10431 datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 25 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

- Në rast derdhjeje aksidentale, toka e ndotur do të hiqet menjëherë, do të grumbullohet siç duhet dhe do të menaxhohet si një mbetje e rrezikshme sipas rregulloreve vendore dhe gjithashtu duke ndjekur standardet e Eni-t.
- Eni do të përgatisë një Plan për reagimin ndaj emergjencave për të adresuar çdo ngjarje të mundshme, përfshirë derdhjet eventuale të naftës. Ekipi i vrojtimit gjeofizik do të trajnohet si duhet për të zbatuar Planin në rast të ndonjë aksidenti.
- Të gjitha mbetjet do të asgjësohen sipas planit të menaxhimit të mbetjeve që do të përgatitet nga Eni para operacioneve, në përputhje me standardet kombëtare dhe të kompanisë.
- Të gjitha karburantet do të transportohen me shumicë në kampin bazë të përkohshëm, ku do të ruhen dhe shpërndahen në mënyrë të përshtatshme sipas nevojës. Të gjitha karburantet do të ruhen në zona të mbyllura dhe furnizimi me karburant do të kryhet në zona të dedikuara me shtresë të fortë/ të papërshkueshme.
- Mbetjet sanitare (ujërat e zeza), ujërat e ndotur urbanë dhe mbetjet e tjera të lëngëta do të trajtohen në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotur dhe do të menaxhohen ose asgjësohen si mbetje në përputhje me planin e menaxhimit të mbetjeve që do të përgatitet nga Eni para operacioneve, në përputhje me standardet kombëtare dhe të kompanisë.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në komponentin ujëra nëntokësorë pritet të jenë të ulëta.*


Ujërat sipërfaqësorë & cilësia e ujërave

Ndikimet e mundshme kryesore të vrojtimit gjeofizik në ujërat sipërfaqësorë, si duke përdorur teknikat e vibrimit ashtu edhe teknikën e puseve plasës, pritet të jenë:

- Degradimi i cilësisë së ujërave. Shkarkimi i substancave ndotëse në trupat e ujërave sipërfaqësorë dhe degradimi i cilësisë së ujërave mund të ndodhë në rast të derdhjes aksidentale të karburantit ose lubrifikantëve, shkaktuar nga mosfunksionimi ose dëmtimi i automjetit gjatë lëvizjeve ose operacioneve të energjizimit. Kampi bazë i përkohshëm, gjithashtu mund të shkaktojë shkarkimin e ndotësve në ujërat sipërfaqësore kur ndodhet pranë rrjetit ekzistues të kullimit, në rast të derdhjes aksidentale të karburantit ose substancave të tjera të rrezikshme në zonat e magazinimit dhe mirëmbajtjes ose gjatë operacioneve të furnizimit me karburant. Gjithashtu cilësia e ujërave sipërfaqësorë mund të ndikohet nga kampet bazë të përkohshme në rast të menaxhimit jo të duhur të ujërave të zeza.
- Sedimentimi i trupave ujqorë. Sedimentimi i trupave ujqorë mund të shkaktohet nga transporti i sedimenteve nga zonat e ndikuara në rrjetin hidrografik lokal dhe lidhet kryesisht me shplarjen e tyre nën veprimin e reshjeve. Menaxhimi jo i duhur i materialit të nxjerrë nga nëntoka gjatë aktiviteteve të shpimit gjithashtu mund të rrisë rrymën e sedimenteve nga zona e shpimit.

Masat zbutëse të propozuara


- Gjatë përvetësimit të të dhënave do të mbahet një distancë sigurie ndërmjet pikave të plasjes dhe ujërave sipërfaqësorë.
- Numri i kalimit të përrenjve do të mbahet në minimum duke përdorur vendet e preferuara të kalimit për të shmangur erozionin e brigjeve.
- Të gjitha masat zbutëse të listuara më parë për adresimin e "Ngjeshjes/erozionit të tokës" (seksioni "Tokat") do të kontribuojnë në shmangien/zvogëlimin e ndikimeve të sipër përmendura.
- Shpëlarja dhe transportimi i sedimenteve nga çdo zonë e ndikuar do të minimizohet duke zbatuar masat e kontrollit të sedimenteve.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 26 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

- Procedurat e kontrollit të mbetjeve të shpimit do të zbatohen për të shmangur çdo shpëlarje dhe transportim të tyre në trupat ujorë sipërfaqësorë. Për më tepër, mbetjet do të përdoren për të mbushur dhe mbyllur pusin pasi të ketë përfunduar shpimi dhe vendosja e ngarkesës.
- Të gjithë shoferët dhe teknikët do të informohen në lidhje me procedurat e furnizimit me karburant, disqet e mbledhjes së derdhjeve dhe mjetet e pastrimit të derdhjeve, përmes trajnimit dhe bisedave periodike.
- Në kampin bazë të përkohshëm, nuk do të ndodhë asnjë furnizim me karburant jashtë zonave të caktuara të karburantit/servisit, përveç se për arsye sigurie/sigurie ose emergjence.
- Të gjitha automjetet dhe makineritë që veprojnë në terren do të mirëmbahen në mënyrën e duhur për të parandaluar rrjedhjet e naftës që mund të ndotin ujërat sipërfaqësorë. Mjetet e pastrimit të derdhjes do të jenë në dispozicion për ndërhyrje të menjëhershme.
- Çdo ri-furnizim me karburant në terren i kamionëve vibrues, kamionëve regjistruar ose operacion mirëmbajtje do të kryhet duke përdorur disqet e mbledhjes së rrjedhjeve dhe derdhjeve dhe mjetet për pastrimin e tyre të disponueshme.
- Të gjithë karburantet dhe lëngjet e tjera të rrezikshme (p.sh., lubrifikantët) do të ruhen në kontenierë të përshtatshëm dhe të sigurt, sipas rregulloreve vendore dhe praktikave të mira ndërkombëtare.
- Në rast derdhjeje aksidentale, toka e ndotur do të hiqet menjëherë, do të grumbullohet siç duhet dhe do të menaxhohet si një mbetje e rrezikshme sipas rregulloreve vendore dhe gjithashtu duke ndjekur standardet e Eni-t.
- Eni do të përgatisë një Plan për reagimin ndaj emergjencave për të adresuar çdo ngjarje të mundshme, përfshirë derdhjet eventuale të naftës. Ekipi i vrojtimit gjeofizik do të trajnohet si duhet për të zbatuar Planin në rast të ndonjë aksidenti.
- Të gjitha karburantet do të transportohen me shumicë në kampin bazë të përkohshëm, ku do të ruhen dhe shpërndahen në mënyrë të përshtatshme sipas nevojës. Të gjitha karburantet do të ruhen në zona të mbyllura dhe furnizimi me karburant do të kryhet në zona të dedikuara me shtresë të fortë/ të papërshkueshme.
- Të gjitha mbetjet do të asgjësohen sipas planit të menaxhimit të mbetjeve që do të përgatitet nga Eni para operacioneve, në përputhje me standardet kombëtare dhe të kompanisë.
- Mbetjet sanitare (ujërat e zeza), ujërat e ndotur urbanë dhe mbetjet e tjera të lëngëta do të trajtohen në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotur dhe do të menaxhohen ose asgjësohen si mbetje në përputhje me planin e menaxhimit të mbetjeve që do të përgatitet nga Eni para operacioneve, në përputhje me standardet kombëtare dhe të kompanisë.
- Për të shmangur çdo rrezik të ndotjes së tokës, nuk do të përdoret asnjë lëng shpimi me kimikate për shpimin e puseve. Do të përdoret vetëm ujë (pa aditivë). Nëse është e nevojshme, në disa raste argjila do të përzihet me ujë për të rritur qëndrueshmërinë e mureve të pusit.
- Sistemi natyror i kullimit të zonës nuk do të ndërpritet: çdo rrugë/gjurmë e re do të pozicionohet dhe do të ndërtohet larg rrjedhave të ujit. Aty ku nuk është e mundur, do të ndërtohen urat sipas standardeve të Eni-t.
- Çdo ndërhyrje në sistemin natyror të kullimit, përfshirë çdo kalim të përkohshëm të rrjedhës së ujit, do të rehabilitohet dhe dhe strukturat do të hiqet duke risistemuar rrjedhën origjinale të ujit.

Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në komponentin ujëra sipërfaqësorë pritet të jenë të ulëta.*

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>27 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

Cilësia e ajrit

Ndikimi i mundshëm kryesor i vrojtimit gjeofizik në cilësinë e ajrit, si duke përdorur vibrimet ashtu edhe teknikën e puseve plasës, pritet të jetë:

- Përkeqësim i cilësisë së ajrit nga shkarkimet në ajër. Shkarkimet në ajër gjatë vrojtimit gjeofizik lidhen kryesisht me gazet e çliruar dhe pluhurin e prodhuar nga aktivitetet e projektit. Shkarkimet e gazeve lidhen me operimin e automjeteve vibruese, paisjeve të shpimit, traktorëve, automjeteve ndihmëse dhe gjeneratorëve të energjisë. Çlirimi i pluhurit mund të shkaktohet nga lëvizja e automjeteve në sipërfaqe të pashtuara dhe nga aktivitetet e pastrimit përgjatë linjave gjeofizike.

Masat zbutëse të propozuara

- Të gjitha rrugët ekzistuese (të asfaltuara ose jo) do të identifikohen gjatë trasimit topografik dhe më pas do të përdoren sa më shumë të jetë e mundur gjatë operacioneve në mënyrë që të shmanget ose minimizohet qarkullimi jashtë rruge, pra çlirimi i pluhurit
- Kamionët vibrues, pajisjet e shpimit dhe automjetet ndihmëse do të mirëmbahen rregullisht për të ruajtur nivelin e shkarkimit të gazeve të djegies në nivelet e parashikuara nga prodhuesi.
- Kudo që të jetë e mundur, automjete ndihmëse kompakte dhe me shkarkime të ulëta do të përdoren për të zvogëluar çlirimet e pluhurit dhe gazeve të djegies.
- Do të vendosen kufizime shpejtësie për të gjitha automjetet për të zvogëluar çlirimet e pluhurit dhe gazeve të djegies.
- Kurdo që është e mundur dhe e nevojshme, ujë i ripërdorur do të përdoret për lagjen e rrugëve me qëllim shtypjen e pluhurit.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në komponentin cilësia e ajrit pritet të jenë **të ulëta**.*


Zhurma & Vibrimet

Ndikimet kryesore të mundshme të vrojtimit gjeofizik lidhur me zhurmën dhe vibrimet, si duke përdorur teknikat e vibrimit ashtu edhe teknikën e puseve plasës, pritet të jenë:

- Rritja e zhurmës së mjedisit për shkak të aktiviteteve të projektit. Sa i përket zhurmës, burimet kryesore përfaqësohen nga operimi i kamionëve vibrues dhe lëvizja e automjeteve ndihmëse. Nëse përdoret metoda e puseve plasës, burimi kryesor i çlirimit përfaqësohet nga pajisjet e shpimit. Do të përdoren pajisjet konvencionale të shpimit, të montuara mundësisht në traktorë ose kamionë me platforma, por aktualisht nuk ka ndonjë specifikim teknik të veçantë në lidhje me çlirimet e tyre të zhurmës por, mund të bëhen supozime të ngjashme me ato që lidhen me operacionet e vibrimit.
- Dëmtimi fizik i strukturave nga dridhjet për shkak të aktiviteteve të projektit. Operimi i kamionëve vibrues dhe automjeteve ndihmëse ose përdorimi i teknikës me lëndë plasëse mund të çojë në dëmtime aksidentale të strukturave, përfshirë ndërtesat, kapononët dhe gardhet. Strukturat që janë të vjetra ose në gjendje të dobët riparimi, infrastruktura nëntokësore, të tilla si puse dhe gropa septike, mund të jenë të ndjeshëm ndaj ndikimeve të vibrimeve. Nivelet aktuale të dridhjeve nga vrojtimit gjeofizike janë të vështira për t'u parashikuar me saktësi pasi kjo varet nga një numër faktorësh. Sidoqoftë, është e mundur të vlerësohet me përafërsi distanca nga burimi në të cilin potenciali për dëmtimin e strukturave ose shqetësimin e banorëve në komunitetet lokale nga dridhjet tokësore minimizohet dhe nën pragjet përkatëse.

Masat zbutëse të propozuara

- Operacionet do të mbahen sa më larg që të jetë e mundur nga ndërtesat e ndjeshme si spitalet, shkollat dhe vendet e adhurimit.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>28 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

- Distanca e sigurisë së operacioneve do të përcaktohen sipas Praktikës më të Mirë të Eni-t "Monitorimi i dridhjeve dhe distancat e sigurisë së radiotransmetuesve" për të vepruar në afërsi të banesave dhe strukturave të tjera, të tilla si monumentet e kulturës¹⁶.
- Në rast të dëmtimit të ndonjë strukture fizike, Eni do të kryejë riparimin e nevojshëm ose do të kompensojë pronarin.
- Aktivitetet e vrojtimit pas përfundimit të ditës do të shmangen sa më shumë që të jetë e mundur, në veçanti ato që lëshojnë zhurmë dhe aktivitete të dridhjeve.
- Burimi i vibrimeve do të vendoset vetëm për periudhën e nevojshme për të përfunduar vrojtimin në secilën pikë burimi.
- Personeli në terren do të marrë trajnime për ndërgjegjësimin mjedisor që përfshin masa të hartuara për të minimizuar tingullin (p.sh., duke minimizuar rrotullimin në boshllëk të motorëve).
- Do të vendoset një Mekanizëm Ankesash për komunitetet dhe individët që të komunikojnë zyrtarisht shqetësimet dhe ankesat e tyre pranë kompanisë dhe të lehtësojë zgjidhjet që janë të pranueshme reciprokisht nga palët në kohë të përshtatshme dhe në mënyrë efektive.
- Komunitetet lokale brenda zonave të operacioneve gjeofizike do të sensibilizohen për projektin dhe ndikimet e mundshme nga zhurmat dhe vibrimet para fillimit të operacioneve.
- Kamionët vibrues, kamionët regjistruer dhe automjetet e tjera do të mirëmbahen rregullisht dhe do të jenë të pajisur me zhurmëkapës për të zvogëluar çlirimet e zhurmës.
- Kudo që është e mundur, do të përdoren automjete kompakte ndihmëse dhe me çlirim të ulët për të zvogëluar nivelin e zhurmës në mjedis.
- Për të gjitha automjetet do të vendosen kufizime të shpejtësisë për të zvogëluar çlirimin e zhurmës.
- Lëvizjet e automjeteve do të minimizohen sa të jetë e mundur.

Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në lidhje me zhurmën dhe vibrimet pritet të jenë të ulëta.*

Administrimi i mbetjeve

Ndikimi i mundshëm kryesor i vrojtimit gjeofizik lidhur me prodhimin e mbetjeve, si duke përdorur teknikat e vibrimit ashtu edhe teknikën e puseve plasës, pritet të jetë:

- Presioni mbi administrimin lokal të mbetjeve. Dy burime kryesore të prodhimit të mbetjeve janë identifikuar:
 - mbetje të lëngëta dhe të ngurta të prodhuara në kampet bazë;
 - dhera potencialisht të ndotur të hequr nga vendodhja në rast të derdhjes së naftës/karburantit nga vibruesit, platformat e shpimit ose automjetet ndihmëse.

Të gjitha mbetjet e prodhuara do të menaxhohen, sipas rregulloreve vendore, brenda kuadrit lokal të administrimit të mbetjeve. Mund të pritet një stres/presion mbi administrimin lokal

¹⁶ Ky dokument përcakton distancat minimale të sigurisë që duhet të zbatohen, bazuar në rregulloren gjermane DIN-4150 "Vibrimet në ndërtesa; efektet në struktura". Megjithatë, për shkak se natyra e vibrimeve të truallit në një distancë n varet shumë nga gjeologjia e zonës, përpara fillimit të aktiviteteve do të kryhen teste në terren për të përcaktuar distancat aktuale që duhen respektuar. Kjo do të bëhet bazuar në DIN-4150 dhe praktikën më të mirë të BNKGJ "Udhëzime për shmangien minimale gjatë kërkimeve sizmike në tokë". VKM nr. 533/2005 datë 07.08.2005 "Udhëzues për rregullat e sigurisë gjatë përdorimit civil të lëndëve plasëse në Shqipëri" gjithashtu do të merren në konsideratë për përcaktimin e zonave të sigurisë në rast të lëndëve plasëse

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>29 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

të mbetjeve në rast të prodhimit të një vëllimi të madh mbetjesh ose të llojeve të mbetjeve të cilat nuk mund të depozitohen/asgjësohen në instalimet lokale të trajtimit/depozitimit, gjë që nuk është rasti i këtij Projekti.

Masat zbutëse të propozuara

- Në rast derdhjeje aksidentale, toka e ndotur do të hiqet menjëherë, do të grumbullohet siç duhet dhe do të menaxhohet si një mbetje e rrezikshme sipas rregulloreve vendore dhe gjithashtu duke ndjekur standardet e Eni-t.
- Të gjitha mbetjet do të asgjësohen sipas planit të menaxhimit të mbetjeve që do të përgatitet nga Eni para operacioneve, në përputhje me standardet kombëtare dhe të kompanisë.
- Linjat e vrojtimit do të shënohen para fillimit të studimit duke përdorur materiale të biodegradueshme (të tilla si bojë, shkumës, shirit, flamur, etj.).
- Mbetjet sanitare (ujërat e zeza), ujërat e ndotur urbanë dhe mbetjet e tjera të lëngëta do të trajtohen në një impiant të trajtimit të ujërave të ndotur dhe do të menaxhohen ose asgjësohen si mbetje në përputhje me planin e menaxhimit të mbetjeve që do të përgatitet nga Eni para operacioneve, në përputhje me standardet kombëtare dhe të kompanisë.
- Brenda zonës së projektit (në Bradashesh) është një landfill sanitar dhe një instalim i shndërrimit të mbetjeve në energji (Incinerator). Nga ana tjetër, ka kompani riciklimi që veprojnë në rajon. Kështu, projekti do të marrë në konsideratë opsionet dhe praktikat më të mira në dispozicion në lidhje me menaxhimin e mbetjeve duke filluar nga ndarja dhe grumbullimi veçmas i rrymave të ndryshme si në kampin bazë logjistik ose të përkohshëm, ashtu dhe në terren. Rrymat e mbetjeve të ricikluar do t'i transferohen kompanive të licencuara, ndërsa për rrymat e tjera do të eksplorohej mundësia e depozitimit në landfill ose dërgimi në Incinerator, sipas procedurave të nevojshme për të shmangur presionin mbi sistemin e administrimit të mbetjeve.


Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në lidhje me administrimin e mbetjeve pritet të jenë të ulëta.*

Komponentët e Biodiversitetit - Habitatet

Aktivitetet e projektit do të zhvillohen kryesisht në habitatet bujqësore dhe gjysmë natyrore. Gjatë operacioneve të projektit mund të kërkohet pastrim i kufizuar i vegjetacionit. Bazuar në informacionin në dispozicion, linjat e përvetësimit të të dhënave ka të ngjarë të mos ndërpresin asnjë habitat të listuar në Shtojcën I të Direktivës së Habiteteve të BE -së.

Ndikimet e mundshme kryesore në habitate të vrojtimit gjeofizik, si duke përdorur vibrimet ashtu edhe teknikën e puseve plasës, pritet të jenë:

- Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit. Ndikimet më të mundshme të drejtpërdrejta në habitat ka të ngjarë të ndodhin gjatë pastrimit të vendit për shkak të zënies së përkohshme të tokës nga linjat e vrojtimit dhe kampi bazë i përkohshëm, lëvizja jashtë rrugës e pajisjeve dhe automjeteve, vendosja e marrësve, prerja e vegjetacionit natyror dhe paisjet e shpimit. Duke qenë se automjetet lëvizin përgjatë linjave të vrojtimit, ekziston mundësia që habitatit në kontakt direkt me gomat të shqetësohet apo edhe të humbasë nën presionin e rrotave. Shqetësimi i tokës për shkak të shpimit të puseve plasës gjithashtu mund të çojë në shqetësim ose humbje të habitatit nëse nuk menaxhohet mirë.
- Futja e mundshme aksidentale e specieve të huaja gjithashtu mund të ketë një ndikim në habitat, duke marrë parasysh që mobilizimi dhe prania dhe e kamionëve, transporti i furnizimeve dhe pajisjeve nga zona të tjera si dhe fuqia punëtore, shërbejnë si vektorë potencialë.
- Ndotja e habitateve tokësore ose ujore mund të jetë një tjetër ndikim i mundshëm. Grumbujt e sedimenteve nga zona e kampit dhe rrugët e aksesit mund të arrijnë në trupat ujorë, ashtu


 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 30 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

si dhe shkarkimi aksidental i naftës dhe kimikateve nga makineritë. Pluhuri i krijuar nga lëvizja e dherave, lëvizja e automjeteve, përgjatë linjave të vrojtimit, rrugëve të aksesit dhe në zonën e kampit mund të depozitohen në bimët, duke zvogëluar kapacitetin e gjetheve për kryerjen e fotosintezës.

Masat zbutëse të propozuara

- Vibruesit do të përdoret kryesisht në zonat fushore, jo në zonat kodrinore/malore ku gjendet ojesa më e madhe e habitateve natyrore të zonës së projektit. Kjo do të zvogëlojë nevojën e hapjes së shtigjeve të reja brenda zonave të ndjeshme për të lejuar kalimin e kamionëve vibrues.
- Të gjitha rrugët dhe shtigjet ekzistuese (të asfaltuara ose jo) do të identifikohen gjatë trasimit topografik¹⁷ dhe më pas do të përdoren sa më shumë të jetë e mundur gjatë operacioneve në mënyrë që të shmanget ose minimizohet qarkullimi jashtë rruge, pra shqetësimi i tokës dhe vegjetacionit si dhe rreziku i shtuar i futjes së specieve aliene.
- Zona e zënë nga pajisjet e shpimit dhe ato ndihmëse do të mbahet në minimumin e mundshëm në mënyrë që të shmanget ose minimizohet ngjeshja/degradimi i tokës, shqetësimi i tokës dhe modifikimi i vegjetacionit/të korrave.
- Çdo zonë që është e ndjeshme për shkak të biodiversitetit dhe vlerës ekologjike do të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur nga projekti.
- Kur shmangia nga një zonë e ndjeshme nuk është e mundur, kohëzgjatja e operacioneve të kufizohet në minimumin e mundshëm.
- Pastrimi i bimësisë, vegjetacionit dhe të mbjellave do të sa më shumë të jetë e mundur për të lejuar përgatitjen zonave të kalimit/vendosjes së marrësve.
- Prerja e pemëve me DLK mbi 10 cm do të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur.
- Në pyje ose ligatina, transporti i pajisjeve do të kryhet kudo që është e mundur me këmbë ose helikopterë.
- Menjëherë pas përvetësimit gjeofizik, çdo zonë e prekur do të rikthehet në kushtet fillestare për të ruajtur funksionet ekologjike dhe çdo rrugë aksesit për në linja e hapur nga Eni, do të mbyllet menjëherë, duke u siguruar që zona të mos jetë më e arritshme.
- Ri-vegjetacioni natyror do të promovohet ose përndryshe, zonat do të ri-mbillen me lloje vendase nëse ri-gjenerimi natyror nuk është i mjaftueshëm.
- Speciet e huaja invazive, nëse vendosen, do të hiqen me metoda miqësore me mjedisin.
- Për të shmangur çdo dëmtim aksidental të specieve/habitatëve të mbrojtura potencialisht të pranishme në zonë do të kryhet ndërgjegjësimi për to i punonjësve dhe kontraktorit që punojnë në terren.
- Kamionët vibrues, sondat e shpimit dhe çdo mjet ndihmës që vjen nga jashtë Shqipërisë për të punuar në zonën e projektit do të pastrohen për të shmangur rrezikun e futjes së llojeve të bimëve të huaja. Në veçanti, gomat e të gjitha automjeteve do të pastrohen në mënyrën e duhur për t'u siguruar që asnjë farë nuk ka mbetur në to.
- Në mënyrë të ngjashme, të gjitha automjetet ndihmëse që qarkullojnë vajtje -ardhje nga zonat e punës në kampin bazë të përkohshëm do të lajnë shpesh gomat për të zvogëluar rrezikun e përshpejtimit të përhapjes së çdo specie bimore të futur më pare.

¹⁷ Është ekzekutuar si pjesë e rikonzijonit të terrenit të zhvilluar nga Eni (në prill) dhe nga kontraktorët gjeofizikë (në korrik) por do të përfundojë gjatë trasimit topografik.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>31 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

- Përveç automjeteve, të gjitha pajisjet e sjella nga jashtë në Shqipëri do të kontrollohen me kujdes për praninë e farërave dhe jovvertebrorëve të vegjël (ose vezëve të tyre) që mund të jenë ngjitur në sipërfaqen e tyre.
- Të gjitha automjetet dhe makineritë që veprojnë në terren do të mirëmbahen në mënyrën e duhur për të parandaluar rrjedhjet e naftës që mund të ndotin ujërat nëntokësorë. Mjetet e pastrimit të derdhjes do të jenë në dispozicion për ndërhyrje të menjëhershme.
- Të gjithë shoferët dhe teknikët do të informohen në lidhje me procedurat e furnizimit me karburant, disqet e mbledhjes së derdhjeve dhe mjetet e pastrimit të derdhjeve, përmes trajnimit dhe bisedave periodike.
- Në kampin bazë të përkohshëm, nuk do të ndodhë asnjë furnizim me karburant jashtë zonave të caktuara të karburantit/servisit, përveç se për arsye sigurie/sigurie ose emergjence.
- Çdo ri-furnizim me karburant në terren i kamionëve vibrues, kamionëve regjistruar ose operacion mirëmbajtje do të kryhet duke përdorur disqet e mbledhjes së rrjedhjeve dhe derdhjeve dhe mjetet për pastrimin e tyre të disponueshme.
- Të gjithë karburantet dhe lëngjet e tjera të rrezikshme (p.sh., lubrifikantët) do të ruhen në kontenierë të përshtatshëm dhe të sigurt, sipas rregulloreve vendore dhe praktikave të mira ndërkombëtare.
- Në rast derdhjeje aksidentale, toka e ndotur do të hiqet menjëherë, do të grumbullohet siç duhet dhe do të menaxhohet si një mbetje e rrezikshme sipas rregulloreve vendore dhe gjithashtu duke ndjekur standardet e Eni-t.
- Eni do të përgatisë një Plan për reagimin ndaj emergjencave për të adresuar çdo ngjarje të mundshme, përfshirë derdhjet eventuale të naftës. Ekipi i vrojtimit gjeofizik do të trajnohet si duhet për të zbatuar Planin në rast të ndonjë aksidenti.
- Shpëlarja dhe transportimi i sedimenteve nga çdo zonë e ndikuar do të minimizohet duke zbatuar masat e kontrollit të sedimenteve.
- Të gjitha masat zbutëse të listuara më parë për adresimin e "Ngjeshjes/erozionit të tokës" dhe "Çlirimit të pluhurit" do të kontribuojnë në shmangien/zvogëlimin e ndikimeve të sipër përmendura.
- Nëse kërkohet nivelimi, shtresa e sipërme e pasur me lëndë organike do të hiqet dhe grumbullohet në vende të përshtatshme për përdorim të mëvonshëm në restaurimin e zonave të prekura.


Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në habitate pritet të jenë të ulëta.*

Komponentët e Biodiversitetit - Flora dhe vegjetacioni

Ndikimet e mundshme në florë dhe vegjetacion do të kufizohen kryesisht në zonën e linjave të vrojtimit, rrugëve të lidhura me to dhe në zonën e kampit.

Ndikimet kryesore të mundshme, si duke përdorur vibrimet ashtu edhe teknikën e puseve plasës, pritet të jenë:

- Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit. Ndikimet më të mundshme të drejtpërdrejta në habitat ka të ngjarë të ndodhin gjatë pastrimit të vendit për shkak të zënies së përkohshme të tokës nga linjat e vrojtimit dhe kampi bazë i përkohshëm, lëvizja jashtë rrugës e pajisjeve dhe automjeteve, vendosja e marrësve, prerja e vegjetacionit natyror dhe paisjet e shpimit. Duke qenë se automjetet lëvizin përgjatë linjave të vrojtimit, ekziston mundësia që habitatit në kontakt direkt me gomat të shqetësohet apo edhe të humbasë nën presionin e rrotave. Shqetësimi i tokës për shkak të shpimit të puseve plasës gjithashtu mund të çojë në shqetësim ose humbje të habitatit nëse nuk menaxhohet mirë.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>32 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

- Futja e mundshme aksidentale e specieve të huaja gjithashtu mund të ketë një ndikim në habitat, duke marrë parasysh që mobilizimi dhe prania dhe e kamionëve, transporti i furnizimeve dhe pajisjeve nga zona të tjera si dhe fuqia punëtore, shërbejnë si vektorë potencialë.
- Ndotja e habitateve tokësore ose ujore mund të jetë një tjetër ndikim i mundshëm. Grumbujt e sedimenteve nga zona e kampit dhe rrugët e aksesit mund të arrijnë në trupat ujorë, ashtu si dhe shkarkimi aksidental i naftës dhe kimikateve nga makineritë. Pluhuri i krijuar nga lëvizja e dherave, lëvizja e automjeteve, përgjatë linjave të vrojtimit, rrugëve të aksesit dhe në zonën e kampit mund të depozitohen në bimët, duke zvogëluar kapacitetin e gjetheve për kryerjen e fotosintezës.
- Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen¹⁸.

Masat zbutëse të propozuara

Masat zbutëse të propozuara për të minimizuar dhe monitoruar ndikimet në florë dhe vegjetacion janë të njëjtat të propozuara për habitatet në seksionin e mëparshëm.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në komponentin flora dhe vegjetacioni pritet të jenë të ulëta.*

Komponentët e Biodiversitetit - Fauna

Ndikimet e mundshme në faunën do të kufizohen kryesisht në zonën e linjave të vrojtimit, rrugëve të lidhura me to dhe në zonën e kampit. Në veçanti, Projekti mund të ndikojë potencialisht faunën përmes humbjes ose shqetësimit të habitateve në të cilat ajo mbështeten.

Ndikimi i projektit në llojet e faunës mund të ndryshojë në varësi të historisë së jetës së secilës specie dhe habitateve të pranishme përgjatë korridoreve të propozuara si të përshtatshme për vendndodhjen e linjave.

Ndikimet kryesore të mundshme në faunë të vrojtimit gjeofizik, si duke përdorur teknikat e vibrimit ashtu edhe teknikën e puseve plasës, pritet të jenë:

- Zhvendosja e përkohshme e kafshëve të egra për shkak të aktiviteteve antropogjene. Humbja dhe shqetësimi i habitatit natyror përmes pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit mund të zvogëlojë habitatet për strehimin, ushqimin dhe folezimin e disa llojeve të faunës. Çlirimet e zhurmës dhe vibrimet mund të jenë një nga faktorët kryesorë të ndikimit që veprojnë në speciet e faunës dhe që lidhen kryesisht me aktivizimin e burimit të energjisë. Ndikimi mund të pritet gjatë periudhës së shumimit, veçanërisht për shpemdët, të cilët mund të frikësohen nga zhurma dhe mund të braktisin fole të tyre. Lëvizja e automjeteve mund të shkaktojë një zhvendosje të përkohshme të më shumë llojeve të lëvizshme nga korridoret dhe zonat përreth në habitate të ngjashme aty pranë. Për shkak të kohëzgjatjes së shkurtër të vrojtimit dhe shpejtësisë së kufizuar të automjeteve, ndikimi pritet të jetë i vogël.
- Rrezik i shtuar i vdekshmërisë së kafshëve të egra lidhur me rritjen e trafikut të automjeteve. Nuk parashikohet ndonjë ndikim domethënës në faunën ujore dhe habitatet përkatëse në rast se vrojtimi gjeofizik ndërpret lumenj duke qenë se numri i kalimit të përrrenjve do të minimizohet duke preferuar përdorimin e vendeve ekzistuese të kalimit.
- Ndotja e habitateve për shkak të derdhjeve aksidentale dhe rrjedhjeve të materialeve/produkteve të rrezikshme nga pajisjet, nëse menaxhimi i pajisjeve nuk është kryer siç duhet, përbëjnë një ndikim tjetër potencial për faunën.

¹⁸ Llojet e rrezikuara dhe të kërcënuara të florës të identifikuar në përshkrimin e kushteve bazë të mjedisit në Draft VNMS.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 33 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

- Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen¹⁹.

Masat zbutëse të propozuara


Masat e propozuara për të minimizuar ndikimet e përshkruara më sipër sipas hierarkisë zbutëse përfshijnë sa vijon, përveç atyre që janë përmendur tashmë për habitatet në seksionin përkatës:

- Para çdo prerjeje të pemëve ose degëve të pemëve, do të konsultohet një Ekolog. Vrojtimi do të përqendrohet veçanërisht në llojet folezues që bëjnë pjesë në kategoritë e mbrojtura dhe në llojet e faunës që mund të kenë lëvizshmëri të kufizuar dhe nuk mund të lëvizin përpara aktiviteteve në terren. Nëse hasen lloje të tilla, duhet të ndiqet procedura e mëposhtme:
 - Mbrojtja e individëve duke rrethuar foletë ose vendet e strehimit;
 - Të shmangët prerja e degëve të pemëve ku identifikohen vendqëndrime/foletë e lakuriqëve të natës;
 - Kur prerja dhe prishja e vendeve të strehimit nuk mund të shmangët për arsye specifike, çdo kafshë e hasur duhet të vendoset me kujdes në një vend tjetër të mbrojtur larg rrezikut.
- Aktivitetet e vrojtimit do t'i përmbahen plotësisht Nenit 6 të Konventës së BERN në lidhje me speciet e mbrojtura të faunës.
- Për të gjitha automjetet e projektit do të vendoset kufizim shpejtësie në rrugë të shtruara dhe të pashtruara, si dhe në kushtet jashtë rrugës, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i vrasjes aksidentale të faunës në rrugë.
- Një Procedurë Operative Standarde (POS) do të përgatitet dhe zbatohet nga Eni gjatë operacioneve për raportimin, trajtimin dhe shpëtimin e faunës së dëmtuar ose të goditur aksidentalisht nga ndonjë prej automjeteve të Projektit. Çdo kafshë e dëmtuar do të dërgohet te një veteriner për trajtim dhe rehabilitimin e duhur.
- Çdo specie e faunës që haset nuk do të shqetësohet derisa të lëvizë vetë. Nëse ndonjë specie e faunës (veçanërisht ato me lëvizshmëri të kufizuar) haset gjatë aktiviteteve të vrojtimit, do të zbatohen masa zbutëse specifike për të siguruar minimizimin e shqetësimeve në masën maksimale të mundshme si më poshtë:
 - Të mos shqetësohet derisa të lëvizë vetë nëse ka hapësirë të mjaftueshme për ta bërë këtë. Kjo përfshin ndërprerjen e menjëhershme të përkohshme të operacioneve nëse është e nevojshme;
 - Sigurohuni që rruga nëpër të cilën vendosi të largohet kafsha është zonë e sigurtë (p.sh., nuk është në një zonë tjetër ku po zhvillohen aktivitete);
 - Nëse rruga e largimit nuk është e sigurt, drejtojeni kafshën në një zonë më të sigurt.
- Ndalohet ushqimi i kafshëve të egra kështu që ato nuk do të inkurajohen të frekuentojnë zonat e projektit ndërsa operacionet janë në vazhdim.
- Në mënyrë të ngjashme, të gjithë ekipit të vrojtimit do t'i ndalohet peshkimi, gjuetia ose gjuetia e paligjshme gjatë operacioneve.
- Pas shpimit para ngarkimit të lëndës plasëse, pusët plasës do të mbyllën përkohësisht me tapa të lëvizshme për të shmangur rënien dhe bllokimin e faunës në to.

Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në komponentin faunë pritet të jenë të ulëta.*

¹⁹ Llojet e rrezikuara dhe të kërcënuara të faunës të identifikuar në përshkrimi e kushteve bazë të mjedisit në Draft VNMS.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>34 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

Komponentët e Biodiversitetit – Zonat e mbrojtura

Siç është treguar në kapitullin mbi kushtet bazë të mjedisit, zonat e mbrojtura në zonën e studimit përfshijnë monumente natyre dhe dy Parqe Rajonale të propozuara²⁰.

Monumentet e Natyrës nuk do të ndërpriten nga linjat gjeofizike sepse ato do të shmangen plotësisht (domethënë, gjurmët e linjave gjeofizike do të devijojnë nga zona buferike prej 200 m e monumenteve të natyrës).

Në lidhje me dy zonat e mbrojtura të propozuara, ndërprerja respektive do të jetë minimale:

- Parku i propozuar Rajonal Grekan: i cili ndërpritet nga linjat e burimeve rreth 1,5 km;
- Parku i propozuar Rajonal Thanë: i cili ndërpritet nga linjat e burimeve rreth 500 m dhe nga linjat e marrësve rreth 200 m.

Duke përdorur një qasje paraprake, ndikimet e mundshme në parqet rajonale të propozuara, edhe nëse nuk krijohen zyrtarisht, vlerësohen në paragrafin tjetër.

Ndikimet kryesore të vrojtimit gjeofizik në Parqet Rajonale të propozuara si duke përdorur teknikën e vibrimit ashtu edhe puseve plasës pritet të jenë të njëjtat me ato të listuara më parë për habitatet, faunën dhe florën/vegjetacionin:

- Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit.
- Zhvendosja e përkohshme e kafshëve të egra për shkak të aktiviteteve antropogjene.
- Rrezik i shtuar i vdekshmërisë së kafshëve të egra lidhur me rritjen e trafikut të automjeteve.
- Futja e mundshme aksidentale e specieve aliene ose invazive
- Ndotja e habitateve tokësore ose ujore
- Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen (fauna)
- Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen (flora)

Masat zbutëse të propozuara

Masat e propozuara për të zbutur ndikimet e përshkruara më sipër sipas hierarkisë së zbutjes, si dhe aktivitetet e monitorimit të parashikuara për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara, përfshijnë listat e raportuara në seksionet e mëparshme për habitatet, florën dhe faunën.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet në zonat e mbrojtura pritet të jenë të ulëta.*

²⁰ Është e rëndësishme të theksohet se për momentin nuk ka asnjë konfirmim se këto parqe do të shpallen si të tillë në të vërtetë. Prandaj, përfshirja e parqeve rajonale të propozuara në kapitujt e përshkrimit të kushteve bazë dhe vlerësimit të ndikimit është një masë konservatore e marrë nga Eni në njohjen e gatishmërisë së autoriteteve lokale për t'i caktuar ato. Nëse parqet krijohen para operacioneve, kufizime shtesë dhe masa zbutëse do të zbatohen në këto zona në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe standardet e Eni.




 Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 35 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------

Tabela 3. Matrica e vlerësimit të ndikimeve mjedisore mbetëse – Pas zbutjes


Receptori	Teknika	Ndikimet	Lloji i ndikimit	Kohëzgjatja e ndikimit	Shtrirja e ndikimit	Shkalla e ndikimit	Niveli i ashpërsisë (manjituda)	Ndjeshmëria e burimit/receptorit	Rëndësia e ndikimit mbetës
Karakteristikat fizike									
Gjeologjia	Vibrues	Paqëndrueshmëria e shpatit e shkaktuar nga emetimi i dridhjeve	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Ndryshimi i morfologjisë sipërfaqësore	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
	Puse plasës	Paqëndrueshmëria e shpatit e shkaktuar nga emetimi i dridhjeve	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Ndryshimi i morfologjisë sipërfaqësore	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
Tokat	Vibrues	Ngjeshje/erozion i tokës	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Përkeqësimi i cilësisë së tokës	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
	Puse plasës	Ngjeshje/erozion i tokës	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Përkeqësimi i cilësisë së tokës	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
Hidro-gjeologjia & cilësia e ujërave	Vibrues	Përkeqësimi i cilësisë së ujërave nëntokësore si rezultat i rrjedhjeve/derdhjeve aksidentale	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
	Puse plasës	Përkeqësimi i cilësisë së ujërave nëntokësore si rezultat i rrjedhjeve/derdhjeve aksidentale ose mbetjeve të lëndës plasëse	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
Ujërat sipërfaqësorë & cilësia e ujërave	Vibrues	Përkeqësimi i cilësisë së ujërave	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Sedimentim i ujërave sipërfaqësorë	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
	Puse plasës	Përkeqësimi i cilësisë së ujërave	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Sedimentim i ujërave sipërfaqësorë	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët

	Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 36 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------


Receptori	Teknika	Ndikimet	Lloji i ndikimit	Kohëzgjatja e ndikimit	Shtrirja e ndikimit	Shkalla e ndikimit	Niveli i ashpërsisë (manjituda)	Ndjeshmëria e burimit/receptorit	Rëndësia e ndikimit mbetës
Cilësia e ajrit	Vibrues	Përkeqësim i cilësisë së ajrit nga shkarkimet në ajër	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
	Puse plasës	Përkeqësim i cilësisë së ajrit nga shkarkimet në ajër	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
Zhurma & vibrimet	Vibrues	Rritja e zhurmës së mjedisit për shkak të aktiviteteve të projektit.	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Dëmtimi fizik i strukturave nga dridhjet për shkak të aktiviteteve të projektit	Direkt	I përhershëm	Lokal	I dallueshëm	I vogël	E ulët	E ulët
	Puse plasës	Rritja e zhurmës së mjedisit për shkak të aktiviteteve të projektit.	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Dëmtimi fizik i strukturave nga dridhjet për shkak të aktiviteteve të projektit	Direkt	I përhershëm	Lokal	I dallueshëm	I vogël	E ulët	E ulët
Administrimi i mbetjeve	Vibrues	Presioni mbi administrimin lokal të mbetjeve	Direkt	I përkohshëm	Rajonal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Medium	E ulët
	Puse plasës	Presioni mbi administrimin lokal të mbetjeve	Direkt	I përkohshëm	Rajonal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Medium	E ulët
Karakteristikat biologjike									
Habitatet	Vibrues	Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit	Direkt	Afatshkurtër	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Futja e mundshme e specieve aliene ose invazive	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Ndotja e habitateve tokësore ose ujore	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët

	Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 37 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------


Receptori	Teknika	Ndikimet	Lloji i ndikimit	Kohëzgjatja e ndikimit	Shtrirja e ndikimit	Shkalla e ndikimit	Niveli i ashpërsisë (manjituda)	Ndjeshmëria e burimit/receptorit	Rëndësia e ndikimit mbetës
Habitatet	Puse plasës	Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit	Direkt	Afatshkurtër	Lokal	I pa dallueshëm	I vogël	E ulët	E ulët
		Futja e mundshme e specieve aliene ose invazive	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Ndotja e habitateve tokësore ose ujore	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
Flora dhe Vegjetacioni	Vibrues	Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit	Direkt	Afatshkurtër	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Futja e mundshme e specieve aliene ose invazive	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Ndotja e habitateve tokësore ose ujore	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen.	Direkt	Afatshkurtër	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
	Puse plasës	Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit	Direkt	Afatshkurtër	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Futja e mundshme e specieve aliene ose invazive	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Ndotja e habitateve tokësore ose ujore	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen.	Direkt	Afatshkurtër	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët

	Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 38 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------

Receptori	Teknika	Ndikimet	Lloji i ndikimit	Kohëzgjatja e ndikimit	Shtrirja e ndikimit	Shkalla e ndikimit	Niveli i ashpërsisë (manjituda)	Ndjeshmëria e burimit/receptorit	Rëndësia e ndikimit mbetës
Fauna	Vibrues	Zhvendosja e përkohshme e kafshëve të egra për shkak të aktiviteteve antropogjene	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen.	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Rrezik i shtuar i vdekshmërisë së kafshëve të egra lidhur me rritjen e trafikut të automjeteve	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Ndotja e habitateve tokësore ose ujore	Indirekt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit	Indirekt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
	Puse plasës	Zhvendosja e përkohshme e kafshëve të egra për shkak të aktiviteteve antropogjene	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen.	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Rrezik i shtuar i vdekshmërisë së kafshëve të egra lidhur me rritjen e trafikut të automjeteve	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Ndotja e habitateve tokësore ose ujore	Indirekt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët
		Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit	Indirekt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	Mesatare	E ulët

 Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 39 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------

Receptori	Teknika	Ndikimet	Lloji i ndikimit	Kohëzgjatja e ndikimit	Shtrirja e ndikimit	Shkalla e ndikimit	Niveli i ashpërsisë (manjituda)	Ndjeshmëria e burimit/receptorit	Rëndësia e ndikimit mbetës
Zonat e mbrojtura	Vibrues & Puse plasës	Humbja/shqetësimi i habitatit natyror si rezultat i pastrimit ose dëmtimit të vegjetacionit	Direkt	Afatshkurtër	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Zhvendosja e përkohshme e kafshëve të egra për shkak të aktiviteteve antropogjene	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Rrezik i shtuar i vdekshmërisë së kafshëve të egra lidhur me rritjen e trafikut të automjeteve	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Futja e mundshme e specieve aliene ose invazive	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Ndotja e habitateve tokësore ose ujore	Direkt	I përkohshëm	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen (fauna)	Direkt	Afatshkurtër	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
		Humbja/shqetësimi i llojeve me interes për ruajtjen (flora)	Direkt	Afatshkurtër	Lokal	I pa dallueshëm	I papërfillshëm	E ulët	E ulët

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>40 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

7 VLERËSIMI I NDIKIMIT SOCIO-EKONOMIK

Duke marrë parasysh kontekstin e përbërësve dhe masat zbutëse të propozuara, asnjë ndikim i rëndësishëm i mundshëm negativ nuk pritet të shfaqet mbi përbërësit socio-ekonomikë nga vrojtimi gjeofizik. Nga ana tjetër, pritet të shfaqen ndikime të rëndësishme pozitive si rezultat i zhvillimit të këtij Projekti.

Ekonomia e kushtet e jetesës

Ndikimet e mundshme kryesore në ekonomi dhe kushtet e jetesës, duke përdorur si vibrimet ashtu edhe pusët plasës pritet të jenë:

Ndikimet pozitive:


- Projekti do të krijojë mundësi direkte dhe indirekte punësimi, për planifikimin dhe ekzekutimin e vrojtimin gjeofizik. Kjo do të sigurojë rritje të të ardhurave (ndikim pozitiv) dhe një mundësi trajnimi dhe zhvillimi për banorët lokalë dhe do të kontribuojë në aktivitetin ekonomik lokal. Fuqia punëtore e projektit do të përbëhet nga afërsisht 150-200 njerëz me aftësi të ndryshme. Pritet që përafërsisht 70% e fuqisë punëtore të rekrutohen në vend.
- Projekti gjithashtu do të krijojë kërkesë për mallra dhe shërbime, duke çuar në një ndikim pozitiv në kompanitë e përfshira në prokurimin e produkteve të tilla. Duke pasur parasysh natyrën e aktivitetëve, shumica e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme do të jenë të llojit të specializuar, por produktet si ushqimi për punëtorët ose shërbimet shtëpiake dhe/ose transporti do të prokurohen në nivel lokal për aq sa është e mundur. Përdorimi i strukturave ekzistuese si hotelet, pensionet ose shtëpitë e vetë punëtorëve për akomodim do të gjenerojë përfitime ekonomike për bizneset lokale.
- Aktivitetet e projektit do të çojnë në rritjen e njohurive për disponueshmërinë e naftës dhe gazit në Shqipëri, duke kontribuar në fund në zhvillimin e sektorit të energjisë në vend. Një kuptim më i mirë i potencialeve hidrokarbure të zonës së vrojtimin do të lejojë marrjen e vendimeve që bazohen në informacion mbi mundësinë për të vazhduar me aktivitetet e mëtejshme të kërkimit dhe prodhimit. Ai gjithashtu do të lejojë planifikimin e aktivitetëve në mënyrën më të përshtatshme dhe efektive, në mënyrë që sektori i naftës dhe gazit të ofrojë një rol pozitiv për ekonominë e përgjithshme të Shqipërisë.

Ndikimet negative:

- Aktivitetet e vrojtimin do të kërkojnë kufizime të përkohshme të aksesit në toka dhe do të zënë pjesë të kufizuara të saj. Kjo mund të ketë ndikime në përdorimin e tokës dhe në prodhimin bujqësor. Sidoqoftë, kur përcaktohet pozicioni i kamionëve vibrues dhe pusëve plasës në fushë, do të shmangët sa më shumë të jetë e mundur toka e kultivuar. Në çdo rast pronarët e tokës do të kompensohen për çdo humbje të mundshme.
- Prania e automjeteve, pajisjeve dhe personelit, si dhe zbatimi i aktivitetëve të projektit, ka potencial të shqetësojë aktivitetet rekreative dhe turistike të pranishme në zonë. Megjithatë, natyra e përkohshme e projektit dhe kohëzgjatja e shkurtër e tij do të thotë që aktivitetet nuk pritet të krijojnë ndikime të rëndësishme negative në këta sektorë ekonomikë.


Masat zbutëse të propozuara

- Kompania do të ndjekë një qasje të pranishme lokale që synon përfshirjen e bizneseve dhe personelit lokal dhe zhvillimin e aftësive praktike në lidhje me nevojat e projektit.
- Kompania do të ofrojë informacion mbi prokurimin, tenderimin dhe proceset e kontraktimit me një qasje transparente dhe të qartë, për të siguruar që garantohet akses i barabartë në mundësitë e dhëna.
- Informacioni mbi mundësitë e prokurimit do t'u jepet bizneseve lokale, përmes komunikimit të duhur me Dhomat e Tregtisë, Shoqatat e Industrisë, autoritetet lokale dhe palët e tjera të përshtatshme.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>41 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

- Për të rritur praninë lokale të projektit, Kontraktori do të synojë të blejë mallra, shërbime dhe materiale nga bizneset vendore aq sa është praktike, në përputhje me qasjen e përfshirjes lokale.
- Proceset e rekrutimit do të jenë transparente, publike dhe jo-diskriminuese, duke ofruar mundësi të barabarta në lidhje me etninë, fenë, gjuhën, gjininë dhe seksualitetin, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe në përputhje me Politikat dhe Standardet e Eni-t; të gjithë kontraktorëve dhe nënkontraktorëve do t'u kërkohet të veprojnë në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe me Politikat dhe Standardet e Eni-t.
- Kontraktori do të japë informacion të qartë mbi procesin e rekrutimit, me theks të veçantë në informimin e komuniteteve lokale për mundësitë e punësimit përmes mënyrave të përshtatshme.
- Natyra e përkohshme e mundësive të punësimit do të komunikohet qartë gjatë procesit të rekrutimit, për të shmangur krijimin e pritshmërive të paplotësuara dhe mosmarrëveshjeve sapo të përfundojë punësimi.
- Do të nxitet ndërgjegjësimi i punëtorëve të huaj që do të ndërveprojnë me komunitetet lokale, mbi kulturën vendase.
- Trajnimi do të ofrohet nga persona të përshtatshëm (trajnerë profesionistë ose punonjës me përvojë).
- Do të zhvillohet një Plan Akomodimi i fuqisë punëtore për të zgjedhur opsionet për strehimin e punëtorëve, duke siguruar standarde të mira jetese për ta, në përputhje me Politikat e Eni-t; plani do të përfshijë një vlerësim të akomodimit në dispozicion dhe shmangien e përdorimit të tepërt të akomodimit në çdo zonë të vetme, në mënyrë që të shmangët konkurrimi me turistët.
- Do të caktohet një person/ekip për trajtimin e marrëdhënieve me komunitetin dhe çështjet e marrjes së lejes për aksesin në toka, në një koordinim të ngushtë me përfaqësuesit e kompanisë. Personi / ekipi i tillë do të jetë person/a me njohuri të gjuhës dhe kulturës lokale dhe mundësisht me përvojë të mëparshme në marrjen e lejes dhe marrëdhëniet me komunitetin në zonë.
- Autoritetet dhe komunitetet lokale do të informohen dhe konsultohen për ndikimet e mundshme për shkak të aktiviteteve të projektit dhe masave zbutëse të planifikuara gjatë gjithë projektit. Aktivitetet e angazhimit do të kryhen në mënyrë transparente, të përshtatshme nga ana kulturore dhe duke siguruar përfshirjen e grupeve të cënueshme, në përputhje me Planin e Përfshirjes së Palëve të Interesit, të përgatitur për projektin.
- Do të zbatohet një Mekanizëm Ankesash që komunitetet dhe individët të komunikojnë zyrtarisht shqetësimet dhe ankesat e tyre pranë kompanisë dhe të lehtësojë zgjidhjet që janë të pranueshme reciprokisht nga palët, në kohë të përshtatshme dhe në mënyrë efektive.
- Një grup i madh masash zbutëse propozohen në Kapitullin 6 (Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis) për të shmangur ose minimizuar humbjen/shqetësimin e kulturave bujqësore ose kullotave dhe uljen e tërheqjes turistike të zonës. Këto përfshijnë, por nuk kufizohen në to:
 - kryerja e operacioneve të vibrimit në rrugët ekzistuese në mënyrë që të shmangët shqetësimi i tokës private dhe të mbjellave;
 - shmangia ose zvogëlimi në minimumin e mundshëm të pastrimit të vegjetacionit për të shmangur efektet e dukshme të pejsazhit.

Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>42 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, **ndikimet e përgjithshme pozitive mbetëse në ekonomi dhe kushtet e jetesës pritet të jenë mesatare deri të larta dhe ndikimet negative mbetëse pritet të jenë të ulëta.**

Mirëqenia

Ndikimet e mundshme kryesore të teknikave të vrojtimit gjeofizik në mirëqenie pritet të jenë:

- Aktivitetet e projektit mund të krijojnë shqetësim për receptorët në afërsi të vendeve të vibrimit dhe puseve të plasjeve, përta i përket çlirimit të zhurmës, dridhjeve dhe pluhurit. Përcaktimi i vendeve të vibrimit dhe puseve të plasjeve do të marrë parasysh praninë e receptorëve të ndjeshëm, për të zvogëluar ndikimet në masën më të madhe të mundshme.
- Përveç kësaj, aktivitetet e projektit mund të kenë efekte në rrugë, për shkak të rritjes së trafikut nga automjetet e projektit. Kjo mund të shkaktojë vonesa dhe rritje të rrezikut të aksidenteve rrugore. Masa specifike zbutëse janë planifikuar për të zvogëluar këto ndikime në masën e mundshme.

Masat zbutëse të propozuara


- Aktivitetet do të planifikohen për të shmangur sa të jetë e mundur pozicionimin e vendeve të vibrimit dhe puseve të plasjeve në afërsi të shkollave dhe objekteve arsimore.
- Aktivitetet do të planifikohen që të shmanget mbyllja e plotë të rrugëve për të garantuar një rrjedhë normale të trafikut.
- Aktivitetet do të planifikohen për të shmangur orët e pikut në rrugët lokale aq sa është praktike.
- Do të minimizohet shpërndarja e çlirimeve të pluhurit.
- Për të gjitha automjetet e projektit do të vendosen kufizimet e shpejtësisë ndërsa qarkullojnë në rrugë të shtruara dhe të pashtuara, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i aksidenteve rrugore dhe çlirimit të pluhurit.
- Me qëllim parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor dhe uljen në zero të lëndimeve të pësuar nga personeli i projektit dhe publiku në përgjithësi, do të zbatohen praktikatat më të mira të sigurisë së transportit.
- Do të caktohet një person/ekip për trajtimin e marrëdhënieve me komunitetin dhe çështjet e marrjes së lejes për aksesin në toka, në koordinim të ngushtë me përfaqësuesit e kompanisë.
- Autoritetet dhe komunitetet lokale do të informohen dhe konsultohen për ndikimet e mundshme për shkak të aktiviteteve të projektit dhe masave zbutëse të planifikuara gjatë gjithë projektit. Aktivitetet e angazhimit do të kryhen në përputhje me Planin e Përfshirjes së Palëve të Interesit, të përgatitur për projektin.
- Do të zbatohet një Mekanizëm Ankesash që komunitetet dhe individët të komunikojnë zyrtarisht shqetësimet dhe ankesat e tyre pranë kompanisë dhe të lehtësojë zgjidhjet që janë të pranueshme reciprokisht nga palët, në kohë të përshtatshme dhe në mënyrë efektive.

Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, **ndikimet negative mbetëse në komponentin mirëqenie pritet të jenë të ulëta.**

Përdorimi dhe pronësia e tokës


Ndikimet e mundshme kryesore të teknikave të vrojtimit gjeofizik në përdorimin dhe pronësinë e tokës pritet të jenë:

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 43 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

- Ndikimet në përdorimin dhe pronësinë e tokës mund të ndodhin për shkak të nevojës për të hyrë dhe zënë përkohësisht tokën gjatë aktiviteteve të projektit, duke krijuar kështu pengesa të mundshme për përdorimet e zakonshme të tokës (bujqësia dhe të tjera). Duhet të vihet në dukje se të gjitha aktivitetet do të jenë të përkohshme dhe se toka do të rikthehet në statusin e saj origjinal në sa më shumë të jetë e mundur sapo të mbarojnë aktivitetet. Për aktivitetet e projektit nuk parashikohet përvetësim i tokës. Gjithashtu, duke përdorur të dy teknikat, mund të ndodhë ngjeshja/degradimi i tokës nëse aktivitetet nuk menaxhohen mirë. Gjeofonët do të vendosen në tokë në pikat e marrjes dhe do të zënë hapësirë minimale për një pjesë të kufizuar të kohës.
- Aktivitetet e projektit që kryhen në toka bujqësore do të kërkojnë një zënie të përkohshme të saj dhe prandaj do të kenë efekte në aktivitetet bujqësore. Ky ndikim do të jetë i përkohshëm, do të përfshijë pjesë të vogla toke dhe do të jetë plotësisht i kthyeshmë pasi të kenë mbaruar aktivitetet e studimit. Aktivitetet e vrojtimit do të shmangin, për aq sa janë praktike, tokat me vlerë të lartë bujqësore.
- Aktivitetet mund të shkaktojnë dëme aksidentale në struktura përfshirë ndërtesat, kapononet, gardhet, puset dhe gropat septike. Gjatë aktiviteteve do të zbatohen distancat specifike të sigurisë. Sidoqoftë, në rast se ndodhin këto dëmtime, ato do të riparohen ose kompensohen plotësisht.
- Aktivitetet gjithashtu mund të shkaktojnë mosmarrëveshje dhe tension midis pronarëve të tokës për shkak të përgatitjeve për aksesin në tokë.

Masat zbutëse të propozuara

- Kohëzgjatja e operacioneve në secilën tokë private do të planifikohet të jetë minimalja e mundshme në mënyrë që të zvogëlohet kufizimi i aksesit të përkohshëm në tokat bujqësore ose aktivitetet e tjera.
- Në terrenet fushore, ku kryhen shumica e aktiviteteve bujqësore, burimi i preferuar i energjisë do të jetë vibrimi dhe dridhjet do të bëhen për aq sa është praktike në rrugët ekzistuese në mënyrë që të shmangen ose zvogëlohen ndikimet në kulturat bujqësore.
- Eni do të përgatisë një Plan të Menaxhimit të Tokës plotësisht në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe bazuar në Standardet Eni-t dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.
- Kalendarit i aktiviteteve të projektit do të planifikohet në mënyrë që të minimizojë konfliktin dhe ndikimet në aktivitetet bujqësore; aty ku është e mundur, brenda programit të vrojtimit, fermerët do të informohen shumë më parë mbi afatin kohor të aktiviteteve, duke u dhënë atyre mundësinë që bimët bujqësore të prekura të korren para pastrimit të linjave.
- Vendndodhja e aktiviteteve të projektit do të planifikohet dhe organizohet në mënyrë që për aq sa është praktike të shmangen vreshtat dhe kultivimet e drurëve frutorë.
- Do të caktohet një person/ekip për trajtimin e marrëdhënieve me komunitetin dhe çështjet e marrjes së lejes për aksesin në toka, në një koordinim të ngushtë me përfaqësuesit e kompanisë. Personi / ekipi i tillë do të jetë person/a me njohuri të gjuhës dhe kulturës lokale dhe mundësisht me përvojë të mëparshme në marrjen e lejes dhe marrëdhëniet me komunitetin në zonë.
- Aksesin në tokë do të respektojë legjislacionin shqiptar dhe Politikën dhe Standardet e Eni-t, të cilat do të përshkruhen në Planin e Menaxhimit të Tokës. Asnjë akses nuk do të kryhet pa miratimin zyrtar nga pronari i tokës ose Autoriteti. Strategjia do të fillojë në mënyrë kronologjike nga zbulimi në shpërndarjen e informacionit, lejimin (nënshkrimet në formularët e lejitimit), lidhjen, regjistrimet e dëmeve aksidentale (nëse ka) dhe pagesën aktuale të kompensimit.
- Kontraktori gjeofizik do të veprojë në një mënyrë miqësore me komunitetin dhe sipas standardeve të Eni-t dhe legjislacionit përkatës, rregulloreve dhe rregullave tradicionale që

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 44 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

mbizotërojnë. Kontraktori do të shmangë çdo paqartësi, vonesa ose mungesë transparence dhe komunikimi në të gjitha nivelet.

- Për të shmangur çdo dëm të shkaktuar nga dridhjet në prona, domethënë shtëpi, gardhe, puse, distancat e operimit të sigurtë do të përcaktohen bazuar në Praktikën e Mirë të Eni-t "Monitorimi i vibrimeve dhe distancat e sigurisë së radiotransmetuesve" për operim në afërsi të shtëpive dhe strukturave të tjera. Ky dokument përcakton distancat minimale të sigurisë që duhet të zbatohen, bazuar në rregulloren gjermane DIN-4150 "Vibrimet në ndërtesa; efektet në struktura". Megjithatë, për shkak se natyra e vibrimeve të truallit në një distancë n varet shumë nga gjeologjia e zonës, përpara fillimit të aktiviteteve do të kryhen teste në terren për të përcaktuar distancat aktuale që duhen respektuar. Kjo do të bëhet bazuar në DIN-4150 dhe praktikat më të mira të BNKGJ "Udhëzime për shmangien minimale gjatë kërkimeve sizmike në tokë". VKM nr. 533/2005 datë 07.08.2005 "Udhëzues për rregullat e sigurisë gjatë përdorimit civil të lëndëve plasëse në Shqipëri" gjithashtu do të merren në konsideratë për përcaktimin e zonave të sigurisë në rast të lëndëve plasëse.
- Në përfundim të aktiviteteve të gjitha zonat e prekura do të pastrohen dhe rikthehen sa më shumë që të jetë e mundur në gjendjen e tyre para operacioneve.
- Shtresa e sipërme e tokës, nëse është gërmuar më parë, do të rigjenerohet në mënyrë që të mundësojë ri-vegjetacion natyror. Zonat e prekura nga ngjeshja e tokës do të plugohen në mënyrën e duhur.
- Do të nxitet ndërgjegjësimi i punëtorëve të huaj që do të ndërveprojnë me komunitetet lokale, mbi kulturën vendase.
- Autoritetet dhe komunitetet lokale do të informohen dhe konsultohen për ndikimet e mundshme për shkak të aktiviteteve të projektit dhe masave zbutëse të planifikuara gjatë gjithë projektit. Aktivitetet e angazhimit do të kryhen në mënyrë transparente, të përshtatshme nga ana kulturore dhe duke siguruar përfshirjen e grupeve të cënueshme, në përputhje me Planin e Përfshirjes së Palëve të Interesit, të përgatitur për projektin.
- Do të zbatohet një Mekanizëm Ankesash që komunitetet dhe individët të komunikojnë zyrtarisht shqetësimet dhe ankesat e tyre pranë kompanisë dhe të lehtësojë zgjidhjet që janë të pranueshme reciprokisht nga palët, në kohë të përshtatshme dhe në mënyrë efektive.


Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet negative mbetëse në përdorimin dhe pronësinë e tokës pritet të jenë të ulëta.*

Infrastruktura dhe shërbimet publike

Ndikimet e mundshme kryesore të teknikave të vrojtimit gjeofizik në infrastrukturë dhe shërbimet publike pritet të jenë:

- Vonesat në trafik dhe rritja e rrezikut të aksidenteve rrugore për shkak të rritjes së trafikut rrugor nga automjetet e projektit. Këto automjete do të përdorin rrugët ekzistuese kudo që të jetë e mundur, dhe për këtë arsye, në përgjithësi do të kenë efekte në sistemin e rrugëve lokale, por duke pasur parasysh numrin e automjeteve të përfshira, nuk do të shkaktojnë një rritje të konsiderueshme të trafikut. Të gjitha rrugët e transportit do të planifikohen paraprakisht dhe do të rishikohen dhe organizohen (sipas nevojës) çdo ditë në mënyrë që të shmangen manovrat në afërsi të receptorëve të ndjeshëm si shkollat, spitalet dhe qendrat e qyteteve.
- Gjatë aktiviteteve mund të ndodhë konsumimi dhe dëmtimi i papritur i rrugëve (veçanërisht atyre të pashtuara) dhe gardheve si rrjedhojë e lëvizjes së pajisjeve dhe automjeteve të projektit. Në raste të tilla dëmet do të riparohen drejtpërdrejt nga kontraktori dhe, nëse është e nevojshme, do të kompensohen në përputhje me Planin e Menaxhimit të Tokës.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 45 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

- Dëmtimet e mundshme nga dridhjet në struktura, përfshirë ndërtesat, kapanonet, gardhet, pusët dhe gropat septike. Bazuar në inventarin e kryer, vendet e vibrimeve dhe puseve të plasjes do të pozicionohen në mënyrë që të shmangin dëmtimet e mundshme në rrjetet e infrastrukturës. Përveç kësaj, distanca të veçanta sigurie do të zbatohen gjatë aktiviteteve.

Masat zbutëse të propozuara

- Në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i aksidenteve rrugore për të gjitha automjetet e Projektit do të vendosen kufizimet e shpejtësisë ndërsa qarkullojnë në rrugë të shtruara dhe të pashtruara.
- Të gjithë shoferët dhe personeli do të marrin trajnimet fillestare, veçanërisht për sigurinë në rrugë, dhe nuk do të fillojnë të punojnë para përfundimit të trajnimit, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Politikën dhe Standardet e Eni-t. Aspektet e sigurisë do të theksohen midis drejtuesve të Projektit, veçanërisht për të siguruar që shoferët të respektojnë kufizimet e shpejtësisë dhe sinjalistikën rrugore në zonat e ndërtuara dhe qendrat urbane.
- Me qëllim parandalimin e aksidenteve në trafikun rrugor dhe uljen në zero të lëndimeve të pësuar nga personeli i projektit dhe publiku në përgjithësi, do të zbatohen praktikë më të mira të sigurisë së transportit.
- Aktivitetet do të planifikohen që të shmanget mbyllja e plotë e rrugëve dhe të garantohet një rrjedhë e rregullt trafiku. Aktivitetet do të planifikohen dhe kryhen në mënyrë që të sigurohet siguria e plotë e personelit dhe trafikut (përdoruesit e rrugës nga palët e treta). Të gjitha lejet e kërkuara do të merren paraprakisht nga autoritetet përkatëse.
- Aktivitetet do të planifikohen për të shmangur aq sa është praktike orët e pikut në rrugët lokale.
- Bashkitë, institucionet shtetërore dhe banorët lokalë do të kontaktohen për të gjetur tubacionet dhe/ose infrastruktura të tjera nëntokësore.
- Për të shmangur çdo dëm të shkaktuar nga dridhjet në infrastrukturë, distancat e operimit të sigurtë do të përcaktohen bazuar në Praktikën e Mirë të Eni-t "Monitorimi i vibrimeve dhe distancat e sigurisë së radiotransmetuesve" për operim në afërsi të shtëpive dhe strukturave të tjera. Ky dokument përcakton distancat minimale të sigurisë që duhet të zbatohen, bazuar në rregulloren gjermane DIN-4150 "Vibrimet në ndërtesa; efektet në struktura". Megjithatë, për shkak se natyra e vibrimeve të truallit në një distancë në varet shumë nga gjeologjia e zonës, përpara fillimit të aktiviteteve do të kryhen teste në terren për të përcaktuar distancat aktuale që duhen respektuar. Kjo do të bëhet bazuar në DIN-4150 dhe praktikë më të mira të BNKGJ "Udhëzime për shmangien minimale gjatë kërkimeve sizmike në tokë". VKM nr. 533/2005 datë 07.08.2005 "Udhëzues për rregullat e sigurisë gjatë përdorimit civil të lëndëve plasëse në Shqipëri" gjithashtu do të merren në konsideratë për përcaktimin e zonave të sigurisë në rast të lëndëve plasëse.
- Pusët e plasjeve nuk do të shpohen më afër se dy herë thellësia e pusit nga çdo linjë elektrike.
- Do të caktohet një person/ekip për trajtimin e marrëdhënieve me komunitetin dhe çështjet e marrjes së lejes për aksesin në toka, në një koordinim të ngushtë me përfaqësuesit e kompanisë. Personi / ekipi i tillë do të jetë person/a me njohuri të gjuhës dhe kulturës lokale dhe mundësisht me përvojë të mëparshme në marrjen e lejes dhe marrëdhëniet me komunitetin në zonë.
- Eni do të përgatisë një Plan të Menaxhimit të Tokës plotësisht në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe bazuar në Standardet Eni-t dhe praktikë më të mira ndërkombëtare.
- Në përfundim të aktiviteteve të gjitha zonat e prekura do të pastrohen dhe rikthehen sa më shumë që të jetë e mundur në gjendjen e tyre para operacioneve. Çdo dëmtim i mundshëm aksidental do të riparohet dhe kompensohet në përputhje me Planin e Menaxhimit të Tokës.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>46 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

- Autoritetet dhe komunitetet lokale do të informohen dhe konsultohen për ndikimet e mundshme për shkak të aktiviteteve të projektit dhe masave zbutëse të planifikuara gjatë gjithë projektit. Aktivitetet e angazhimit do të kryhen në mënyrë transparente, të përshtatshme nga ana kulturore dhe duke siguruar përfshirjen e grupeve të cënueshme, në përputhje me Planin e Përfshirjes së Palëve të Interesit, të përgatitur për projektin.
- Do të zbatohet një Mekanizëm Ankesash që komunitetet dhe individët të komunikojnë zyrtarisht shqetësimet dhe ankesat e tyre pranë kompanisë dhe të lehtësojë zgjidhjet që janë të pranueshme reciprokisht nga palët, në kohë të përshtatshme dhe në mënyrë efektive.

Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet negative mbetëse në komponentin infrastruktura dhe shërbimet publike pritet të jenë të ulëta.*

Trashëgimia kulturore


Aktivitetet e projektit mund të çojnë në ndikime si në trashëgiminë kulturore materiale ashtu edhe në atë jomateriale nëse nuk menaxhohen siç duhet. Ndikimet e mundshme kryesore të teknikave të vërtetimit gjeofizik në trashëgiminë kulturore pritet të jenë:

- Dëme të rastësishme të aseteve të trashëgimisë kulturore të panjohura/të pazbuluara²¹. Për shkak të pranisë potenciale të objekteve të panjohura me vlerë të mundshme të trashëgimisë kulturore në zonën e projektit, Eni do të ketë një arkeolog në dispozicion për thirrje në rast se ekipet gjeofizike të vërtetimit gjejnë ndonjë objektiv të mundshëm. Projekti do të shmangë dhe mbajë një distancë sigurie nga të gjitha vendet e trashëgimisë kulturore të identifikuara. Për më tepër, do të krijohet një procedurë për gjetjet e rastësishme që të garantohet se ndiqen hapa të veçantë nëse gjatë aktiviteteve të vërtetimit identifikohen mbetje arkeologjike.
- Përsa i përket trashëgimisë kulturore jomateriale, ndikimet lidhen me çlirimin e zhurmës dhe dridhjeve që mund të ndodhin nëse aktivitetet ndërhyjnë në ngjarjet dhe festimet lokale, të cilat mbahen gjatë vitit në vende dhe Bashki të ndryshme brenda zonës së projektit. Do të kryhet një verifikim i ngjarjeve lokale për të siguruar që aktivitetet e Projektit të mos përkojnë me to ose që ndërhyrjet të jenë minimale.
- Lidhur me aspektet pamore, ndikimet mund të ndodhin kryesisht për shkak të pastrimit të bimësisë përgjatë vijave të studimit dhe për rrugët e aksesit.

Masat zbutëse të propozuara

- Për të shmangur çdo dëmtim të shkaktuar nga dridhjet në monumentet dhe vendet e trashëgimisë kulturore, distancat e operimit të sigurtë do të përcaktohen bazuar në Praktikën e Mirë të Eni-t "Monitorimi i vibrimeve dhe distancat e sigurisë së radiotransmetuesve" për operim në afërsi të shtëpive dhe strukturave të tjera. Ky dokument përcakton distancat minimale të sigurisë që duhet të zbatohen, bazuar në rregulloren gjermane DIN-4150 "Vibrimet në ndërtesa; efektet në struktura". Megjithatë, për shkak se natyra e vibrimeve të truallit në një distancë n varet shumë nga gjeologjia e zonës, përpara fillimit të aktiviteteve do të kryhen teste në terren për të përcaktuar distancat aktuale që duhen respektuar. Kjo do të bëhet bazuar në DIN-4150 dhe praktikat më të mira të BNKGJ "Udhëzime për

²¹ Gjatë vërtetimit për kushtet e mjedisit, vendet dhe monumentet e njohura të trashëgimisë kulturore janë identifikuar dhe hartëzuar. Rezultatet e këtij vërtetimi u ndanë me Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) të Elbasanit, në një takim të mbajtur në Prefekturën e Elbasanit më 21 Korrik 2021 dhe korrespondencën e mëvonshme me postë elektronike, për shqyrtimin dhe vërtetimin e tyre. Pas këtij takimi, DRTK ndau me Eni-n informacionin në dispozicion për të gjitha monumentet dhe vendet e Trashëgimisë Kulturore dhe Eni vazhdoi me ndryshimet përkatëse. Në të njëjtin takim Eni shpjegoi se vërtetimi gjeofizik do të respektojë distancat e sigurisë për të gjitha vendet dhe monumentet e TK dhe si do të përcaktohen këto distanca (detaje në listën e masave zbutëse) dhe mori reagime pozitive nga DRTK. Prandaj, duke zbatuar këtë qasje Eni supozon se ndikimet në vendet dhe monumentet e njohura të trashëgimisë kulturore materiale do të shmangen plotësisht dhe se nuk kërkohen masa të tjera.

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 47 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

shmangien minimale gjatë kërkimeve sizmike në tokë". VKM nr. 533/2005 datë 07.08.2005 "Udhëzues për rregullat e sigurisë gjatë përdorimit civil të lëndëve plasëse në Shqipëri" gjithashtu do të merren në konsideratë për përcaktimin e zonave të sigurisë në rast të lëndëve plasëse. Për shkak të pranisë potenciale të objekteve të panjohura me vlerë të mundshme të trashëgimisë kulturore në zonën e projektit, Eni do të ketë një arkeolog në dispozicion për thirrje në rast se ekipet gjeofizike të vrojtimit gjejnë ndonjë objektiv të mundshëm. Nëse gjendet ndonjë objekt i panjohur/i pazbuluar më parë me vlerë të mundshme të trashëgimisë kulturore materiale, do të informohen menjëherë autoritetet dhe linja gjeofizike do të devijohet për ta shmangur atë, duke respektuar distancat e sigurisë të përmendura më parë.

- Bimësia, pastrimi i barit dhe kullotave do të minimizohen sa më shumë që të jetë e mundur gjatë përgatitjes së linjave të vrojtimit, kompensimit ose përgatitjes së zonave të kalimit/vendosjes së marrësit. Meqenëse në zonat kodrinore/malore, ku gjenden shumica e habitateve natyrore të zonës së projektit, burimi i preferuar i energjisë do të jenë pusët plasës, nevoja për pastrimin e bimësisë do të jetë minimale. Gjithsesi, Eni do të përdorë sa më shumë që të jetë e mundur rrugët ekzistuese të aksesit dhe do të përdorë sonda shpimi portative në mënyrë që të zvogëlojë më tej nevojën për pastrimin e bimësisë
- Do të kryhet një verifikim i ngjarjeve lokale për të siguruar që ato të mos përkojnë me aktivitetet e projektit ose që ndërhyrjet të jenë minimale. Për më tepër, aktivitetet e angazhimit të palëve të interesit do të lejojnë identifikimin e elementeve të mundshëm shtesë të trashëgimisë kulturore jomateriale që mund të ndërthuren me projektin.
- Nëse gjatë operacioneve gjenden mbetje arkeologjike nëntokësore të panjohura/të pazbuluara, do të zbatohet një procedurë specifike e gjetjeve të rastësishme, e cila do të përgatitet nga Eni para operacioneve, në përputhje me legjislacionin vendas dhe standardet e kompanisë, me indikacione të qarta mbi hapat që duhen ndjekur në raste të tilla.
- Autoritetet dhe komunitetet lokale do të informohen dhe konsultohen për ndikimet e mundshme për shkak të aktiviteteve të projektit dhe masave zbutëse të planifikuara gjatë gjithë projektit. Aktivitetet e angazhimit do të kryhen në mënyrë transparente, të përshtatshme nga ana kulturore dhe duke siguruar përfshirjen e grupeve të cënueshme, në përputhje me Planin e Përfshirjes së Palëve të Interesit, të përgatitur për projektin.
- Do të caktohet një person/ekip për trajtimin e marrëdhënieve me komunitetin dhe çështjet e marrjes së lejes për aksesin në toka, në një koordinim të ngushtë me përfaqësuesit e kompanisë. Personi / ekipi i tillë do të jetë person/a me njohuri të gjuhës dhe kulturës lokale dhe mundësisht me përvojë të mëparshme në marrjen e lejes dhe marrëdhëniet me komunitetin në zonë.

Janë parashikuar aktivitete vijuese monitorimi për të siguruar zbatimin dhe efektivitetin e masave zbutëse të propozuara.

Duke marrë parasysh zbatimin e masave zbutëse të përcaktuara, *ndikimet negative mbetëse në komponentin e trashëgimisë kulturore pritet të jenë **të ulëta**.*




	Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 48 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------

Tabela 4. Matrica e vlerësimit të ndikimeve socio-ekonomike mbetëse – Pas zbutjes (të dy teknikat janë konsideruar njëkohësisht)


Receptori	Teknika	Lloji i ndikimit	Kohëzgjatja e ndikimit	Shtrirja e ndikimit	Shkalla e ndikimit	Niveli i ashpërsisë (manjituda)	Ndjeshmëria e burimit/ receptorit	Rëndësia e ndikimeve mbetëse
Ekonomia dhe kushtet e jetesës	Punësimi në projekt duke krijuar të ardhura të rritura – ndikim pozitiv	Direkt	Afatshkurtër	Kombëtare	E dallueshme	I vogël	Mesatar	Ndikim pozitiv mesatar
	Prokurimi i mallrave dhe shërbimeve në nivel lokal dhe kombëtar – ndikim pozitiv	Direkt	Afatshkurtër	Kombëtare	E dallueshme	I vogël	Mesatar	Ndikim pozitiv mesatar
	Rritja e njohurive për disponueshmërinë e naftës dhe gazit në Shqipëri, duke kontribuar në zhvillimin e sektorit të energjisë në vend	Direkt	Afatgjatë	Kombëtare	Shumë e dukshme	Mesatar	Mesatar	Ndikim pozitiv i lartë
	Humbja/shqetësimi i të mbjellave ose kullotave për shkak të aktiviteteve të projektit	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
	Ulja e tërheqjes turistike ndaj zonës për shkak të zhurmës dhe shqetësimit të krijuar nga projekti dhe ndikimit vizual (ndikimi në peizazh)	Indirekt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
Mirëqenia	Shqetësim ndaj receptorëve lokalë për shkak të zhurmës dhe dridhjeve	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	E ulët	E ulët

	Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 49 nga 52
----------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------

Receptori	Teknika	Lloji i ndikimit	Kohëzgjatja e ndikimit	Shtrirja e ndikimit	Shkalla e ndikimit	Niveli i ashpërsisë (manjituda)	Ndjeshmëria e burimit/ receptorit	Rëndësia e ndikimeve mbetës
	Vonesa në trafik dhe rrezik i shtuar për aksidente rrugore	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	E ulët	E ulët
Përdorimi i tokës dhe pronësia	Kufizimi i përkohshëm i aksesit në tokat bujqësore gjatë aktiviteteve të përvetësimit gjeofizik	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
	Humbja/shqetësimi i të mbjellave ose kullotave në linjat e vrojtimit, rrugët e aksesit ose kampin bazë të përkohshëm	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
	Dëmtimet nga dridhjet në struktura, përfshirë ndërtesat, kapanonet, gardhet, pusët dhe gropat septike	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
	Mosmarrëveshje dhe tension midis pronarëve të tokës për shkak të përgatitjeve për aksesin në tokë	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
Infrastruktura dhe shërbimet publike	Vonesa në trafik dhe rrezik i shtuar i aksidenteve rrugore për shkak të rritjes së trafikut rrugor nga automjetet e projektit	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët

	Eni Albania	Data 16 Gusht 2021	Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021	faqe 50 nga 52
-----------------------------------------------------------------------------------	-------------	-----------------------	--------------------------------------	-------------------

Receptori	Teknika	Lloji i ndikimit	Kohëzgjatja e ndikimit	Shtrirja e ndikimit	Shkalla e ndikimit	Niveli i ashpërsisë (manjituda)	Ndjeshmëria e burimit/ receptorit	Rëndësia e ndikimeve mbetës
	Konsumimi dhe dëmtimi i papritur i rrugëve (veçanërisht atyre të pashtuara) dhe gardheve si rrjedhojë e lëvizjes së pajisjeve dhe automjeteve të projektit	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
	Dëmtimet nga dridhjet në struktura, përfshirë ndërtesat, kapanonet, gardhet, pusët dhe gropat septike	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
Trashëgimia kulturore	Dëmtimi i rastësishëm i pasurive të trashëgimisë kulturore të panjohura/të pazbuluara	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
	Shqetësim në aktivitetet kulturore lokale për shkak të zhurmës dhe dridhjeve	Direkt	E përkohshme	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët
	Efektet pamore të ndryshimit në peisazh për shkak të pastrimit të bimësisë	Direkt	Afatshkurtër	Lokale	E dallueshme	I papërfillshëm	Mesatar	E ulët

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data</p> <p>16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n.</p> <p>ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe</p> <p>51 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------	-------------------------------------------------	------------------------------

8 NDIKIMET E MUNDSHME NDËRKUFITARE

Nuk është e aplikueshme për këtë projekt.

Duke pasur parasysh vendndodhjen e projektit nuk priten ndikime ndërkufitare. Në fakt, zona e ndikimit të projektit (ZeN), domethënë zona në të cilën mund të shfaqet ndikimi direkt ose indirekt mbi rreçëtorët mjedisorë e sociale, ndodhet krejtësisht brenda kufijve shqiptarë.

9 PËRFSHIRJA E PALËVE TË INTERESIT

Mendimet/qëndrimet, opinionet dhe shqetësimet për projektin e propozuar të palëve të ndryshme të interesit përfshirë, përfaqësues të komuniteteve lokale, grupe interesi, organizata të shoqërisë civile, agjenci shtetërore dhe çdo palë tjetër që mund të jetë e lidhur me projektin, përfaqësojnë një të dhënë të rëndësishme për çdo VNMS.


Një Plan i Përfshirjes së Palëve të Interesit (PPPI) u zhvillua si bazë për angazhimin me komunitetet e ndikuara përgjatë gjithë procesit të VNMS-së së projektit Vrojtim gjeofizik 2D në Bllokun Dumre. Objektivi i përgjithshëm i PPPI ishte të përcaktojë aktivitetet e përfshirjes së palëve të interesit dhe zbulimit publik të informacionit duke paraqitur kështu aktivitetet e veçanta që do të ndërmarrë Eni për përfshirjen e palëve të interesit gjatë ciklit të projektit.

Përfshirja fillestare e palëve të interesit në projekt u zhvillua gjatë fazës së përcaktimit të çështjeve, nga 12 deri më 16 Prill 2021 duke përfshirë autoritetet në nivel kombëtar dhe lokal. Angazhime të mëtejshme u zhvilluan gjatë fazës së përshkrimit të kushteve të mjedisit të projektit në mes të Maj 2021 me fokus në mbledhjen e informacionit, veçanërisht në lidhje me trashëgiminë kulturore, burimet ujore, aspektet sociale (përfshirë përdorimin e tokës), ekologjinë dhe çdo receptor tjetër të ndjeshëm të mundshëm. Takimet konsultative të zhvilluara në Korrik 2021, përfshinë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (Zyra e Elbasanit) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (Zyra e Elbasanit) dhe një takim të përbashkët me Organizatat Rajonale dhe Kombëtare Jo -Qeveritare. Qëllimi i këtyre raundeve të takimeve ishte konsolidimi i gjetjeve bazë dhe marrja e pikëpamjeve të palëve të interesit për VNMS -në në përgjithësi. Përveç kësaj, tre raunde takimesh me Administratorët e AU, ku do të mbahen dëgjesat publike, u zhvilluan nga 28 Korriku deri më 20 Gusht 2021. Këto takime kishin për qëllim dakorësimin për organizimin dhe mbajtjen e Dëgjesave Publike.

Një përmbledhje e palëve kryesore të interesit të konsultuar gjatë VNMS-së është paraqitur më poshtë. Për më tepër, 23 Dëgjesa Publike janë planifikuar të mbahen gjatë periudhës 15 Shtator-30 Shtator 2021, në të cilat do të marrin pjesë një përfaqësuesve të sektorëve të gjerë të qeverisë dhe komunitetit, si dhe OJQ-të, bizneset lokale dhe anëtarët e publikut.

Tabela 5. Përmbledhje e përfshirjes së palëve të interesit gjatë VNMS-së

Faza e përcaktimit të çështjeve	Përgatitja e draft VNMS-së (vrojtimit për kushtet e mjedisit)
<p>Autoritetet kombëtare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) • Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) • Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) 	<p>Departamentet teknike (p.sh., pyjeve, ujërave, planifikimit, ekonomisë dhe financës, bujqësisë dhe kullimit, Ndërmarrjet e ujësjellës kanalizimeve) të Bashkive:</p>

 <p>Eni Albania</p>	<p>Data 16 Gusht 2021</p>	<p>Dokumenti n. ENI ALB-HSE-001-2021</p>	<p>faqe 52 nga 52</p>
------------------------------------------------------------------------------------------------------	-------------------------------	----------------------------------------------	---------------------------

<p>Autoritetet e Bashkive</p> <ul style="list-style-type: none"> • Elbasan, • Cërrik, • Belsh, • Peqin, • Lushnje, • Tiranë, • Kuçovë 	<ul style="list-style-type: none"> • Elbasan, • Cërrik, • Belsh, • Peqin, • Lushnje, • Drejtoria Rajonale e Trashëgimise Kulturore (Zyra Elbasan) • Agjencia Rajonale e Mjedisit (Zyra Elbasan) • Organizatat e shoqërisë civile* • Administratorët e Njësive administrative që ndërpriten nga linjat e vrojtimit gjeofizik.
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

* Shënim: Rreth 20 OJF të rregjistruara në Qarkun e Elbasanit dhe në nivel kombëtar u ftuan të merrnin pjesë në takim por prej tyre vetëm "Klubi Ekologjik Elbasan" ishte i pranishëm në takim.